
Begzat RRAHMANI
GJARPËRINJTË E FUSHËS STERILE
Kërçovë, 2011

BEGZAT RRAHMANI

GJARPËRINJTË E FUSHËS STERILE

(O P I N I O N E)

Kërçovë, 2010

Biblioteka: JEHONA

Redaktor:

Recensent:

Lektore: Prof. Gëzime Baftiri

Ballina:

EDHE TEUTA ËSHTË E JONA

Përpara disa ditësh, rastësisht u takuam me një shok të fëmijërisë. Dhe pasi isha në afërsi të banesës sime i thash që të pinim një kafe te unë. Shoku pa mos u mendua tha se me gjithë qejf do pimë. Më tepër se një orë biseduam dhe u çmallëm me njëri-tjetrin. Përpara se të largohet më tha:

-A s' më jep ndonjë vepër tënden, kam dëgjuar se keni botuara mjaftë ?! I thash urdhëro të shkojmë në dhomën e punës. Pasi ishte hera e parë që ishte në banesën time, u habit kur pa se biblioteka ime është aq e pasur. Rastësisht e pa një libër(fotokopje) që përpara disa muajsh ma kishte dhuruar një bashkëfshatar, si e kontrolloi mirë më tha:

-Qenka i mirë, edhe unë dua ta kem në bibliotekën time., i thash se s' ka problem e bëjmë fotokopje.

Përpara se afroheshim te libraria ku bëjnë fotokopje takuam një shok, që dikur kishim punuar bashkë në një organizatë pune. Si e pa materialin që unë e mbaja në dorë, ku me germa të mëdha shkruante: TEUTA të autorit Mirash Martinoviç, si me ironi tha:

- Edhe kjo është e jona, i thash Ju lumtë çdo gjë që është e mirë dhe person me nam është i juaji. Neve na e morët; Nënë Terezën, gati është të na e merrni edhe Skënder beun, ja tash nga goja jote doli fjala edhe për Teutën, grekëve ua merrni krejt që është greke, po ashtu silleni edhe me bullgarët, ju lumtë i thash, prej kurrkush bëheni dikush. Prapë ashtu me ironi më tha:

- Ne nuk jemi si Ju, duke pasur peshkun të marrim krimbin. Juve u udhëheqin njerëzit LOJAL të PUSHTETIT si në kohën e turkut MJEKRROSHAT, e ÇALLMOSHAT ata me ju luajnë atë lojën e biliardit të xhepit, ju nuk dini ata ç' kanë nën mitan. Sa nuk ka dalë fjala prej gojës së pushtetarëve maqedon se Ju SHQIPTARËT në Maqedoni jeni FUNDAMENTALISTA, që me fjalët që dalin nga ata që u udhëheqin nëpër ura dhe nëpër sheshe, bile edhe kabinete më bota është bindur se ju jeni MUXHAHEDINË, dhe miq të besueshëm të Osama Bin Lladenit, nuk bëni zhurmë për atë që duhet. Unë pasi i dëgjova këto fjalë i thash:

- Për çfarë ne duhet të bëjmë zhurmë, ai ashtu i nervozuar tha:

- Për gjuhën zotëri, për kulturën, për historinë dhe...unë ia ktheva se bëjmë zhurmë, por askush nuk na dëgjon, ai prapë i nervozuar tha:

- Zhurmë bëni, por jo zhurmë të vërtetë, a nuk shikoni se me çfarë fjalori përgjigjen njerëzit tuaj? Me

çfarë fjalori i thash, pse tha a nuk dini? Jo i thash, atëherë të tregoj unë. Ata që ju u thoni kompetentë thonë:

-Projekti nuk është përgatitur mirë, është i ngutshëm, është lehtësues për Ju kurse për ne është ngarkesë e sa e sa fjalë pa lidhje, që do të thotë se ata i kanë dhënë dritë jeshile dhe i japin gjuhës time, që fëmijët tuaj ta mësojnë prej klasës së parë. Atëherë unë thash:

- Ç' duhet të bëjmë, kur Ju e sollët atë Volebekun, që me siguri (me një torbë të madhe) ishit marrë vesh me te që ai të vijë dhe ta shpalli atë projekt famëkeq, dhe ai të jetë si ndërmjetësues, apo lehtësues siç keni qejf Ju tu thoni në kohën e fundit. Prapë ai me nervositet tha:

- Pse ai Volebeku nuk shkon atje në Kosovë dhe ato rregulla tamam për pakica ti tregojë atje, por këtu në Maqedoni ua tregon Juve, që krekoseni se jeni kaq apo aq e më këtë tregoni se jeni pakicë bile më e vogël se pakica. Neve prej kur na thonë se duhet të ndërrojmë emrin, edhe atë e tërë bota, dhe ka më shumë se 20 vjet, por neve nuk na ha palla, kurse Ju për 2 a 3 muaj edhe atë vetëm prej një ministri, jeni duke i mbushur pantallonat, unë nuk di sa i meritoni ato pantallona, ne e dimë rrezikun dhe dëmin e ndërrimit të emrit, kurse Ju aspak nuk jeni të vetëdijshëm për atë që kërkojmë ne nga ju, ajo është e

njëjtë me atë që kërkon bota dhe greku nga ne. ?! I ndjeri baba dikur më ka thënë:

- Për një kolltuk të butë e hëngra dhe e hëngrëm një kunj të fortë. Tash më tha shkoni e bëni atë që duhet ta bëni, por ruaje këto libër mos ta shikon ndonjë tjetër se menjëherë nesër do të shkruajnë gazetat se edhe ZONJA E MADHE MBRETËRESHA TEUTË ËSHTË E JONA ...

SUPER KOMBI

Sa kishim hyrë në dekadën e parë të mileniumit të tretë edhe atë sipas Krishtit, prej te vila e bukur “BILJANA” të Ohrit u paraqit reporteri i televizionit duke lajmëruar se së shpejti do të paraqitet personi kompetent për të lajmëruar, ose më mirë të them për të na marrë sihariqin “MREKULLINË” e të gjithë kohërave prej kurrë ekziston njerëzimi në planetin TOKË. Ne në kafenenë ku e pinim pijen me shtatëqind qejfe i hapëm sy e veshë ka monitori që ishte përballë nesh. Nuk shkuan as dy minuta doli personi i aq shumë pritur dhe me një copë letër në dorë, duke shikuar dhe lëvizur djathtas e majtas ia nisi në atë stilin e vet:

- Më ne shqiptarët s’ kemi ç’ kërkojmë më shumë në këtë shtet, prej sot jemi KOMB. Në lokal jehuan zërat, kurse përjashta edhe krismat. Njëri shok i imi që ishte në tavolinë tjetër mu afrua dhe më tha:

- A të kujtohet ai personi atje në Prishtinë kur na tha, se paska thënë ZONJA e MADHE se do t’ ia shohim sherrin, unë u habita dhe vetëm pohova me kokë. Të nesërmen të gjitha gazetat shkruan se në PREAMBULLË do të jetë vetëm SUPER KOMBI, kurse ne shqiptarët do të jemi KOMB së bashku me

ato që deri dje s' ishin kurrkund, ne ishim KOMBËSI. Sihariqi më i madh ishte kur, po ashtu përpara kamerave doli KRYESHTETARI i sotshëm e tha:

- Ju bëni çka të doni, por unë kur do të vite në pushtet do bëjë modelin e Amerikës. Ky vend është vend BIBLIK, por mos harroni se edhe SUPER KOMBI është po ashtu BIBLIK. Dikush shkoi edhe më larg e tha:

- Edhe ZOTI paska lindur në këtë vend, dhe mu aty ku ndodhet KRYQI, që i han krejt të ardhurat e KOMBEVE, e veçanërisht të shqiptarëve.

Parlamentarët tonë, gojën plot, apo siç thotë populli " gojën vesh më vesh" në foltoren e parlamentit e përdornin fjalën KOMB dhe po ashtu shikonin djathtas majtas bile edhe lart, dhe mendonin se ja kush jem ne, ju na i thatë votat, por ja ne ç' bëjmë për Ju. Por nuk shkoi shumë kohë një parlamentar i SUPER KOMBIT kur përherë të parë e përdori termin SHQIPTARËT MAQEDON, të gjithë u shikuan, por asnjëri nuk bëri zë. Prej atë ditë PARTALLMENTARËT tonë filluan në PARTALLMENT të përdorin temat: KOMUNITET, BASHKËSI, PAKICË, dhe atë KOMBIN e bënë vetëm një FIQO të ndryshkur dhe kalbur.

Nuk shkoi shumë kohë Super Kombi, solli vendim sipas modelit amerikan gjuhën e vet ta bëjnë, prej asaj ZYTARE në atë SHTETËRORE. Të gjithë

bënë AMIN, pasi jetojnë me qira në shtetin, apo në tokën BIBLIKE. Duke i ruajtur djerrinat i humbën arat dhe oborret e shtëpive.

Të nesërmen pas shpalljes gjuhë shtetërore u paraqit ministri me dekret:

-Maqedonishtja prej klasës së parë, dhe pikë, prej kësaj s' ka kthim prapa. Zonjat e mëdha dhe zotërinjtë e mëdhenj filluan të dalin me mendime të ndryshëm, por të gjithë në favor të gjuhës shtetërore. Ne s' dimë ku e mësuan dhe kush ua mësoi atë; psikologji, pedagogji, metodikë, apo atë shkencë sekrete të këtij mileniumi të tretë, ku thuhet dhe shkruhet se për fëmijën tënd 100 kilogram janë një barrë e lehtë, kurse për mua dhe fëmijën tim një kilogram është shumë, apo një barrë tepër e rëndë, ju lumtë ky na qenka zbulimi epokal, për partallmentarët tanë më falni kështu u thoshte dikur Baca Salë-Kërçova. Pas disa ditësh zyrtarizmin e kësaj gjuhe filluam ta shohim edhe nëpër muret dhe fasadat e ndërtesave nëpër qytete, por edhe nëpër rrugët kryesore të SHTETIT BIBLIK, por tash shkohet edhe më larg, ku në një vend shkruante: " Gjuha shtetërore, qysh në mitër të nënës". E mua më vajti mendja te fjalët e pleqve, apo të hoxhallarëve kur dikur thoshin:

- Ky fëmijë është apo s' është i hairit, ose i mbarë apo i prapët, është bërë, apo s' është bërë me bismilah. Tash sipas vendimeve dhe ligjeve shtesë të parlamentarëve dhe të ministrave ku për fat të keq

bëjnë pjesë edhe ata të jonit, që po sa kanë hyrë në Qeveri ua kanë shpërlarë trurin dhe ato BIBLIKËT i çojnë vërdallë apo siç thuhet te ne, luajnë herdhet, apo cjapin, kur të fillohet fëmija duhet të thuhet:

- “Të filloj në emër të SHTETIT BIBLIK dhe të punosh për KOMBIN BIBLIK”. Parlamentar dhe juve ministra shqiptarë Zoti ju marroftë, më falni gabova ZANA ju SHITOFTË...?!

KALI FAL NA ZHYTI NË BATAK

Qysh si fëmijë shpesh herë kam dëgjuar nga më të vjetërit thënien" KALI FAL NUK SHIKOHET TE DHËMBËT". Dorën në zemër, përmbajtja e kësaj thënie shumë më ka munduar, bile njëherë më kujtohet kur xha Biti në një tubim si e dëgjoi këtë thënie, iu drejtua atij personit që e tha, me këto fjalë:

- Po, keni të drejtë, por AI KALË SHUMË HERË NA KA LËNË NË MES TË BALTËS, ose më vonë ia kemi parë SHERRIN. Edhe kjo përgjigje më është ngulitur në kokë dhe shpeshherë më kujtohet, ndonjëherë për të mirë, por më shumë për të keq.

Një ditë kur në gazetë lexova për LIBRIN E MUZIKËS, por edhe për shumë libra të tjerë, që më kanë renë në dorë dhe i kam shfletuar me vëmendje, prapë mu kujtua ajo thënia popullore, që e ceka pak më lartë.

Po ai shoku që ma tërhoqi vërejtjen për Teutën, dje më habiti, se sa mirë i kishte analizuar këngët tona TALLAVAJAT, BAKLLAVAJAT apo HALLVAHAJAT, s' më kujtohet se si i shqiptoi saktësisht. Po ashtu më tregoi, se vetë shumë ishte habitur, dhe kurrë se kishte pritur një ndodhi të tillë, prej atij DEPUTETIT PLAK, që rastësisht ishin takuar te URA e GURIT dhe kishin shkuar bashkë

deri te TEMPULLI i Bit Pazarit. Siç më tha se ai ish deputeti, prej te vend takimi e deri atje me asnjërin s'ishte përshëndetur SHQIP. Prapë shoku i përmendi do fjalë; si taraba, hallava, salama, por edhe në gjuhët e tij nga kombi, që me të vërtet tha i kishte ardhur shumë mirë, dhe se atje në Shkup s' paska shqiptarë. Si mbërrimë tha përpara xhamisë ai e pa orën dhe më tha:

- Unë do të shkoj të bëjë një rend, është pak herët, por të zë një vend te rendi i parë, ai përdori një fjalë tjetër, që unë se kuptova, por mendoj se ajo fjalë ishte për rendet në faltore. Unë i thash:

- Ani se unë nuk jam kryeministër, edhe unë do të vij, ai më kapi për krahu dhe më tha:

- Të lumtë, ti qenke më i madh se ato më të mëdhenjtë. U ulëm së bashku te rendi i parë. Ligjëruesi, ligjëronte me afsh në shumë gjuhë, i lumtë, sa i aftë që ishte, por assesi ligjërata si ngjante gjuhës shqipe. Unë nervozohesha, kurse ai vazhdoi duke më thënë:

- Zotëri çdo e dyta fjalë pas shqipes e ligjëruesit ishte; arabe, turke, çifute, por edhe në gjuhën time. Mua mu rrotullua pllaka në kokë, se edhe unë asi farë ligjëratash kam dëgjuar sa herë që kam vizituar, apo jam falur e lutur në xhami, por nuk ua kam venduar veshin. Prandaj tha mos u mërzit dhe mos u nervozo, për librat e juaj pse janë të përziera me gjuhë të ndryshme të botës e veçanërisht me atë timen-

SHTETËRORE. Ju ato persona të zgjedhur të fesë dhe politikës i paguani shumë trashë dhe ato u asimilojnë, kurse ne tash ua botojmë librat, edhe atë pa asnjë lek, dhe ua japim fëmijëve tuaj. Kurse mua prapë mu kujtua ajo thënia e pleqve, e veçanërisht ajo e xha Bitit" KALI FAL NUK SHIKOHET TE DHËMBËT", por " AI KALË NA ZHYT NË BATAK". Ndoshta prej vitit të ardhshëm nëpër ato LIBRA SHKOLLOR do të kthehen edhe toponimet si në kohën e LIMANOVSKIT, për myslimanët, por ndoshta edhe diçka më të re dhe më interesante si ajo nga AKADEMOSKËT. Ndoshta edhe modeli i ligjërimit të atij në xhami, do të fillojë të zbatohet edhe nëpër shkolla. Prapë shoku me një ton nervoz dhe të habitshëm më tha:

- Ju zotëri, deri sa nuk i respektoni FATOSAT, PIONERËT, NXËNËSIT dhe rininë tuaj ashtu si NE dhe e tërë bota, Juve u dënon dhe do tu dënojë ZOTI...???!!! Unë i nervozuar i thash:

- Ç' doni të thoni me këto fjalë, ç' bëjmë ne?! Ai edhe më i nervozuar më tha:

- Vërtetë nuk dini?!

- I thash jo. Atëherë të tregoj unë, por dëgjo mirë, dhe ia nisi:

- Shkollat e Juaja janë në situatë të mjerueshme. Bankat të copëtuara, pa ujë, pa nevojtore, pa nxehje, pa drita, me plotë pluhur dhe lagështi dhe ku ta dijë unë edhe sa e sa të këqija. Fëmijët tuaj aty rrinë, në

ato kushte çnjerëzore nga tri apo katër orë, dridhen si pula të lagura në shi, kurse ti dhe ai DEPUTETI ME NAM, por edhe ai plaku që është përpara vdekjes, për pesë, dhjetë, apo njëzet minuta lutje-falje keni bërë kushte PERËNDIMI, dhe doni të shkoni përpara, JOOO ZOTËRI, Ju ua shkatërroni fëmijëve tuaj shëndetin, NA dhe ATO LIGJËRUESIT me kushte komod ua trullosim trurin. Deri sa Ju ta ktheni gjuhën e PASTËR SHQIPE, ta caktoj mirë nëpër FALTORE, nëpër rrugë PËRSHËNDETJET e të mos flasim për GJUHËN nëpër shkolla, nga Ju s'ka PËRPARIM as respekt nga NE e aq më pak RESPEKT dhe NDIHMË nga ZOTI. Bota Ju njeh si popull me PENDLA ARI, kurse Ju vetveten e mbuloni, apo DEKORONI me pendla TENEQEJE...?!

BUNDESTAGËT

Nuk më kujtohet saktësisht data dhe muaji, por më kujtohet mirë se ishte fundi i mandatit të dytë në sistemin demokratik. Isha lodhur duke shkruar me makinën Olympia, që edhe pak mbush gjysmë shekulli, dhe akoma më shërben si në ditët e para, e ruaj me fanatizëm, pasi e kam kujtimi nga bashkëfshatari, punëtori i pa lodhur i arsimit, dhe i KAUZËS KOMBËTARE i çmuar dhe i respektuar i ndjeri prof. Mustafa Pinjolli.

Kur me padurim prisja ti radhisë edhe vargjet e fundit, si sot kur e shkruaj këtë punim, cingëroi telefoni. Vajza ime e vogël erdhi dhe më tha:

- Babi është për Ju. Unë u ngrita dhe shkova aty ku ndodhej telefoni. I thash të faleminderit jam i nderuar, po, po do të vij, dhe iu ktheva punës. Pa mos e mbaruar vargun, gruaja ma solli kafen. Dhe me atë stilin e policit më tha:

- Prej kujt je i nderuar, ku do të shkosh?! Prit i thash, ta mbaroj fjalinë. Ajo i mblodhi disa fletë që unë i kisha bërë shuk dhe i kisha hedhur nëpër dhomë. Si u mbusha me frymë, por me shumë mundim nga ASTMA e ndyrë... i thash:

- Më thirri kryetari i KOMUNËS RURALE, dhe më duket se ishte hera e parë që e përdora atë

fjalë, paska një delegacion të jashtëm. Si i dëgjoi këto fjalë me letrat shuk u fut në kuzhinë.

Nëntëmbëdhjetë pa pesë minuta isha te restorant "KOKOLI". Atje në skaj te tavolina, që përherë shkruante e rezervuar ishin të ulur dy persona, shokët tonë. Njëri më thirri, kur u afrova, më tha:

- Shpejt vjen edhe kryetari. Unë sa bëra porosinë kryetari me dy persona tjerë hyri te dera, unë asnjërin nuk e njihja. Pa u ulur na njoftoi me MIQTË, pastaj edhe ata me ne. Njëri nga ata si na shikoi disa herë, herë njërin herë tjetrin, shikimin e ndali tek unë, dhe mu drejtua në atë STILIN PERËNDIMOR, bile pak edhe më ashpër:

- Zotëri, unë me Ju kam kohë të bisedoj vetëm pesëmbëdhjetë minuta. Unë s' di pse ashtu dhe aq shpejt bile edhe ashpër reagova:

- Zotëri, unë me Ju, skam kohë të bisedoj as pesë sekonda. Kryetari reagoi duke më thënë të kemi kujdes. Kurse miku edhe më ashpër më tha:

- Kush je ti zotëri, që s' ke kohë të bisedosh me mua as pesë sekonda, kurse unë vijë nga BUNDESTAGU Gjerman?! Unë iu përgjigja:

- Zotëri unë jam ky që jam, e sa për Ju kush jeni dhe prej nga vini mua aspak nuk më intereson. Kryetari prapë edhe më i nervozuar më tha, të jem më i kujdesshëm. Miku me atë SHQIPEN e pastër, por një të folur të ngadalshme dhe tonin më të ulët, prapë më tha:

- Pse jeni aq të plogësht zotëri?! Atëherë edhe unë pak më qetë i thash:

- Më vjen mirë që, një GJERMAN e flet aq bukur gjuhën time. Ai plot krenari tha:

- Unë i kam ndjekur disa KURSE dhe SEMINARE të gjuhës shqipe, te profesorë me nam edhe pse profesioni im është ekonomia. Dhe unë kam erdh për të mirën Tuaj?! Unë më qetë ia fillova:

-Zotëri Ju përpara se të vini në Maqedoni, me siguri jeni përgatitur një kohë të gjatë, dhe po ashtu keni lexuar raportet MAQEDONE për ne SHQIPTARËT. Dhe me siguri ato kanë qenë ZI e më ZI, p.sh: ne jemi IRRIDENTISTA, SEPARATISTA, TERORISTA, DROGISTA e ku ta di unë edha sa ISTA e ISTA të tjera. Dhe prej BUNDESTAGUT tënd ke erdh në BUNDESTAGUN MAQEDON, edhe aty të kanë KËNDUAR mirë, dhe unë për ato pesë minuta duhej vetëm të pohoj atë, që Juve u është ngulitur me pa të DREJTË dhe pa FAKTE dhe ARGUMENTE në KOKË. Gjermani u habit, dhe tha:

- Pajtohem, por me këtë nuk di sa pajtohen PARLAMENTARËT e juaj, por edhe zoti KRYETAR! Unë prapë ashtu qetë, bile edhe më qetë iu përgjigja:

- PARLAMETARËT tonë si hynë në PARLAMENT dhe japin BETIMIN, ulen në FOTELJET e BUTA, harrojnë krejt, bile e SHPËRLAJNË edhe TRURIN. Kurse unë të fol mirë

për gjendjen e kaluar POLITIKE, por edhe për këtë momentale të KOMBIT tim atëherë me TRURIN tim s' është diçka në rregull. Ne këtu që jemi të gjithë kemi mbaruar fakultetin, apo shkollën e lartë në Prishtinë. Unë për fat të mirë nuk kam qenë i burgosur, por disa nga këto, që janë ulur kanë vuajtur nëpër KAZAMATET SLLAVE, dhe kanë qenë të përjashtuar nga puna, por jo për MOS DIJE, por siç thoshin në atë kohë" KANË PARË NË ËNDËRR KALIN E BARDHË". Unë do të flas diçka edhe për gjendjen ekonomike, edhe atë në emër të më shumë se njëqind mijë pensionistëve, që jetojmë me afër pesëdhjetë marka gjermane në muaj. Në këtë numër shqiptarë ka shumë pak, sepse prindërit tonë kanë qenë BUJQ, por edhe ato të tjerët si unë dhe Ju, janë njerëz dhe kanë të drejtë të jetojnë një jetë normale. Kurse Parlamentarët, por edhe kryetari kanë RROGË më shumë se njëzet pensione tonat. Unë u kisha pyet Juve ZOTËRI i BUNDESTAGUT, po të ishit JU dhe dikush në shtetin tënd me këtë pension, dhe me këto të DREJTA, por të mos harrojmë se edhe rrogat tjera nuk janë më të mira. Çka do të bënit?! Zotëriu me një ton mallëngjyes:

- Më vjen shumë keq, për të gjithë, por sikur të isha unë në gjendjen tënde, dhe me gjithë këto vepra, por edhe si gjerman i thjesht me siguri se do të kisha bërë disa herë VETËVRASJE. Unë si e shikova edhe njëherë orën, i thash:

- Mua më vjen keq, që u bënë shumë minuta, bile më shumë se dhjetë herë se sa Ju kishit planifikuar të bisedoni me ne, por prej kësaj bisede dhe prej leximeve, që keni bërë gjatë seminareve dhe kurseve për ne SHQIPTARËT, për shembull, për NËNË TEREZËN, SKËBDERBEUN, KADAREN dhe shumë të tjerë BESOJ se prej kokës SUAJ më janë SHKULUR ato të thënat dhe raportet TË PA VËRTETË SLLAVE.

E sa për veprat unë e kam AMANET prej xha Bitit plak, që dikur më ka thënë: "NIPÇE, mundohu diçka të mbjellësh, si ato të kombeve të tjerë, që kanë gërvisht në; dru, gurë, gjethe e lëkurë. Ju tash keni gjuhën, por edhe germat, që ne dikur si kemi pasur". Prapë duke e parë orën i thash:

- Zotëri PALAMENTAR u bënë plot dy qind minuta, Ju falënderohemi nga zemra. U ndamë duke shtrënguar duart si miq të moçëm, por me porosi të BUNDESTAGUT, JO PALAMENTARË SHQIPTARË, KREKOSXHI E GJAKPIRRËS TË POPULLIT E **P U L A** DHE AMINXHI NË PARLAMENT...

VËLLAI I VËLLAIT

Tregu i fruta-perimeve ishte i zbrazur, pasi ishte ditë e diel. Por tregun e kishin zaptuar disa qen endacak, ndoshta kishte edhe prej atyre të tjerëve. Mua më ranë në sy ata qentë tjerë që ecin vertikalisht, por dëmet i bëjnë në HORIZONTALE. Njëri kishte hipur në një tezgë dhe vështronte në të gjitha anët, majtas, djathtas, lart, poshtë, sikur të ishte ndonjë LIDER, apo prej atyre me dylbi, që shikojnë edhe pas malit, për të bërë operacionet e planifikuar të natës e pastaj të vinë, e të të qajnë ditën si ALIGATOR.

Vazhdova rrugën përmes çarshisë si ai trimi me KALIN E BARDHË, bile edhe FLAMURIN e kisha në kokë, se në krahë dorën në zemër, s' ma mbante, frikohesha ma shikonin ATA, që thonë se duhet të jemi pesëdhjetë e një për qind, se atëherë qenkëshim SHQIPTARË. Ne në këtë ÇANAK-USKANË që jemi, na thonë:

- Paramendoni se ÇANAKU është i THYER, JU S' JENI, por duhet të JENI të COPTUAR. Sepse ajo BILJANA e BUKUR, u solli LIGJE ÇFAROSËS, kurse ne më falni ATO me KOKËN GJOK e me MENDJEN ZOG, filluan të fluturojnë, prej njërit KAURROCIONI në atë tjetrin KAURROCION, që sa vjen e më tepër ZBEHET ajo BUKURIA, por më

tepër ajo që ne dhe të parit tonë i kanë thënë; TRIMËRI dhe KRENARI KOMBËTARE.

I vendosur se me asnjërin s' do të përshëndetem, as me TARABA, e as me DOBRABA, e as do të bisedoj, vazhdova prapë përmes çarshisë duke menduar se jam në Durrës, e jo në çanakun, apo në KALANICËN e PËRDHOSUR. Dhe kur kaloi ajo aroma e qebapëve, nuk eca as dhjetë hapa dikush më thirri në emër. Nuk e ktheva kokën, por ai me këmbëngulje bërtiti edhe disa herë. Një person që unë nuk e njihja, e ndodhej përpara meje, e ktheu kokën pas dhe më tha në emër se mua më thirrin. E ktheva kokën dhe u nisa në drejtim të vëllait. Ai u ndal te dera e kafenesë dhe sa mbërrita më tregoi se ishte me VËLLAIN e vet, por në atë moment edhe vëllai i vëllait më pa. Rashë në mat pozicion, as të hy në kafene, por as të kthehem prapë, dhe të vazhdoja rrugën si miza pa kokë. Vëllai i vëllait u ngre më dha dorë dhe e hoqi karrigen dhe më tha:

- Urdhëroni, uleni, prej kurrë kam dëshirë të pimë një kafe bashkë. Me vëllamë përherë pimë kafe, raki, bile hamë edhe dreka dhe darka, por me ty asnjëherë s' kemi pasur rastin. Unë kisha pasur dëshirë, siç jam me vëllain, me ty të jem edhe më afër dhe më i lidhur. Vëllai im atë e pohoi disa herë, se ajo na qenka diçka e shkëlqyer, bile edhe MREKULLI e kohës. Ma porositën kafen, por edhe ujë me gaz siç i thonë atje, që e përmenda më lartë se dikur po ta

përmendja në kohën e VËLLAIT të VËLLAIT, do ti haja pesëmbëdhjetë vjet të mira.

Vëllai i vëllait me shumë kujdes dhe DASHAMIRËSI ma shpalli dëshirën, që prej kurrë paska dashur të pimë kafe dhe të ma thotë atë MREKULLINË e kohës. Vëllai prapë me gojën vesh më vesh e sytë, na si bila. E përshëndeti propozimin e vëllait. Njësoj si ai që tha:

- Edhe heronjtë tonë kanë folur dy gjuhë. Por nuk na tregoi se cilët HERONJ, ato të PËRMENDOREVE apo ato të KOLLTUQEVE dhe na kanë pasur MIQËSI dhe BINJAKËZIME apo MOTËRZIME, siç kërkonte nga unë vëllai i vëllait.

Si vëllait tim, po ashtu edhe vëllait të vëllait u thash:

- Ju lumtë sa bukur e keni përgatitur, bile edhe më bukur dhe më me precizitet se sa ai MINISTRI. Përveç që ne të flasim atë gjuhën zyrtare tash më SHTETËRORE, unë dhe ti vëlla i im nëpër zyra, në shkollë, në kafene, në rrugë, tash mundoheni që ajo gjuhë të hyjë edhe nëpër shtëpitë tona edhe atë në mënyrë shumë perfide. Ti VËLLA i vëllait tim, që insiston që fëmijët tonë, të mit dhe të tuat të shoqërohen, apo të MOTËRZOHEN siç thau ti, duhet edhe të kushtëzohen edhe nga unë, e jo vetëm nga ti. Atëherë ai vëllai i vëllait i nervozuar dhe me habi më pyeti:

- Ç’ doni të thoni ju?! I thash shkurt e shqip do të them:

- Ajo s’ duhet të ndodhi, sepse ne nuk jemi as farë e as fis. Por nëse vjen rasti që fëmijët tuaj të vinë dhe të bredhin siç thoni ju me fëmijët e mijë, apo të kundërtën atëherë, fëmijët tonë duhej të flasin gjuhën e njëri tjetrit, edhe atë, bile shumë mirë, ju ashtu thoni. Nëse fëmijët e mijë e flasin gjuhën tënde, e të tuat nuk e flasin gjuhën time, atëherë s’ ka MOTËRZIM. Vëllai i vëllait, por edhe ai imi prej kësaj përgjigjeje boll u nervozuan. Vëllai i vëllait e nxori atë të keq, nga barku, apo siç i thonë te ne HOMLE, që unë nuk di a është fjalë shqipe. Duke e shikuar vëllain tha:

- Unë e kam ditur se ti nuk je njeri i mirë, prej atëherë kur kërkuat ta ndërroni mbiemrin prej në OSKI në I. Unë nuk di çka të pengonte dhe të pengon ty ajo OSK-I-A?! Edhe unë i nervozuar bile edhe me ton të lartë i thash:

-Ç’ të pengonte, dhe të pengon ty ajo VIQ-KA dhe OV-KA, mua më pengonte dhe më pengon ajo OSK-I-A...?! Bindu se më nuk jemi ato të para pesëdhjetë vjetëve. Shumë mirë ti e dinë ç’ thotë ai pedagogu, por ajo është shkruar shumë decenie përpara tij në BIBLËN tënde:”SILLU ME ATË SIÇ SILLET AI ME TY”. Hiqe më nga mendja atë PLEHËR të kohës së TITOS. Bënit krime dhe nuk përgjigjeshit, kurse ne nuk kishim të drejtë as të tregojmë, se ndaj nesh ishin

kryer KRIME. Tash e kemi atë mundësi të tregojmë, këtu por edhe më larg, bile edhe ti kthejmë ato KRIME me KRIME, edhe pse nuk jemi të asaj NATYRE...

GJARPËRINJTË E FUSHËS STERILE

E kisha lexuar disa herë Statutin e Punës së Bashkuar, por iu ktheve edhe njëherë, aty ku flitej për obligimet dhe të drejtat e vendit të punës ku unë, edhe disa ditë i bëja plotë një muaj.

Arkëtari filloi të shpërndajë rrogat, unë si u përshëndeta me ato punëtorë që i njihja, po ashtu edhe me ato që si njihja, u vërtetova se në atë Njësi të Punës së Bashkuar "KUARC- KUARCIT", vërtetë afër nëntëdhjetë për qind ishin shqiptarë. Dorën në zemër rrogat ishin të majme, te punëtorët ndihej kënaqësia.

Si u kthyem në qendër edhe unë e mora rrogën, u habita, kur në dorë kisha më tepër se një rrogë e gjysmë të arsimtarit. Por u habita edhe më tepër kur pash se arkëtari kishte edhe shumë më shumë se unë, por edhe disa vende të tjera pune që kishin shumë më pak përgjegjësi se sa kishte vendi i punës sime.

Të nesërmen duhej për të njëjtin karakter pune të shkonim në Njësinë e Manganit. Rruga ishte jo e përshtatshme, por një bukuri e rrallë natyrore, me plot cicërima zogjsh. Kur mbërrimë lexova te pllaka njëmijë e katërqind e njëzet metra mbi lartësinë detare. Prapë arkëtari filloi të shpërndajë rrogat, u

dëshpërova edhe më shumë, dhe sa vinte e më shumë bindesha me padrejtësitë, që përpara disa ditësh kishim biseduar me shoferin.

S' di si dhe pse e hapa derën në anën e djathtë ku ndodheshin një grumbull, kazmash, lopatash e shetërish. Brenda pash dy persona, që bisedonin në lidhje me TORNON, me të vërtetë u habita kur e pashë atë makinë aq të shtrenjtë. Njëri mu afrua, më përshëndeti dhe më pyeti:

-A ke letërnjoftim?! Unë u habita, i thash kam në shtëpi, por jo këtu, ai prapë më pyeti:

- A dini ç' është letërnjoftimi?! Unë prapë i habitur i thash po, pse më pyet?! Plaku ashtu tha kot, shumica e punëtorëve shqiptarë nuk e dinë. Atëherë unë e pyeta:

- Prej ku e dini ju këtë fjalë shqipe?! Plaku si e lëkundi kokën u përgjigj:

- Me babën, si fëmijë dhe disa fshatarë shpesh shkonim në Durrës për kripë, por dhe vizitonim do të afërt, nga nëna, por edhe nga baba, që shumë më ka marrë MALLI, dhe policët na pyetnin për letërnjoftimet.

Kur u ktheva te arkëtari, punëtorët bisedonin, për rrogat, e njëri u tha:

- Vetëm inxhinieri slloven ulte normën e trashte rrogat, kurse këto të Titos bëjnë të kundërtën. Unë prapë u habita pse nuk janë të kënaqur me rrogat aq të majme, kurse te shqiptarët ndihej kënaqësia, edhe pse

trashësia e rrogave në anën veriore te SHQIPTARËT ishin shumë më të vogla.

Më ngeli edhe një ditë punë në teren. Të nesërmen si një ditë më parë, u nisëm për te Njësia e Mermerit, por atë ditë na u bashkua edhe njëri nga drejtorët. Si udhëtuam më tepër se një çerek ore, shoferi kthehu në anën e majtë. Pas dy a tre minutave tha:

- Tash hymë në terrenin e FUSHË së THATË. Edhe atë në gjuhën shqipe, drejtori dhe arkëtari u shikuan njëri me tjetrin, por nuk thanë asnjë fjalë, edhe unë heshta. Sa e kaluam lakesën e parë, një GJARPËR mjaftë i madh na preu rrugën. Ata prapë heshtën, kurse unë, përveç që u lemerisa, mendja më vajti edhe për ndonjë KOB. Kjo më tepër u shtua kur pas tre katër minutave u zbrazën disa BATARE. Shoferi më shikoi dhe më tha:

- Mos u friko, janë manovrat e Ushtrisë Jugosllave, dhe në një largësi prej afër njëqind metrash u paraqit një ushtar me flamur të kuq. U ndalëm disa minuta, me siguri pasi mbaruan manovrat, dhe kaloi rreziku na dha shenjë që të vazhdonim. Pas disa minutash shoferi duke kthyer kokën pas tha:

- Tash jemi afër fshatit SOP, të djegur deri në themel, ja shikohet një pjesë e murit të xhamisë, kurse ato shtëpitë që duken atje larg janë të BËLLGARISË SË VOGËL. Arkëtari dhe drejtori prapë u shikuan,

por nuk thanë asnjë fjalë, kurse shoferi me xhipin LANDROVER kthehu në të djathtë, ku më filloi të duket fabrika e Mermerit, që gëlltiste disa miliona dollarë investime të huaja.

Kur mbërrimë te fabrika drejtori dhe arkëtari u ndalën aty, kurse unë me shoferin vazhduam për te qendra. Aty më pritën mirë, i bëmë krejt regjistrimet e mensës. Aty e hëngra edhe drekën e parë me shoferin dhe disa punëtorë. Motra e medicinës së bashku me mësuesin e fshatit sa arritën, menjëherë motra e vendoi xhezven e kafes. Na duke e pirë kafen, me xhipin e organizatës arriti edhe arkëtari, që tua shpërndante rrogat. Gjellëbërësi kryesor sa e pa arkëtarin e solli një shishe me raki shtëpie që e kishte pjekur vet. Dhe sa e hapi kundërmoi një aromë kumbullash. E pimë nga një, por arkëtari dhe gjellëbërësi e mbushën edhe nga një tjetër, kurse unë i refuzova, atëherë arkëtari tha se hisen time do ta pinte ai, dhe si e piu të dytën e mbushi edhe të tretën.

Pas disa minutash në sallë hynë disa punëtorë, që duhej edhe ata të merrnin rrogën, dhe duhej të vazhdonin punën në turnin e dytë. Njëri ishte mjaftë i dehur, por edhe të tjerët s' ishin të pa pirë, sa më pa ai i dehuri e pyeti gjellëbërësin:

- A është ky ai shqiptari, dhe e kapi një taketuke të xhamit dhe u drejtua në drejtim timin, kurse unë iu afrova shishes me raki. Shoferi që rrinte pak më larg i

ulur në një karrige u ngrit, dhe me një ton të ashpër u tha:

- Merrni rrogat dhe hupeni, se të gjithave do tu bëjë shoshë. I dehuri u zbyth, kurse njëri nga të tjerët tha:

- Ne s' bëmë gjë, ai është mjaftë dehur. Kurse ai trimi dhe të tjerët, pasi i morën rrogat duke dalë te dera tha:

- Faji është i atyre, kur e dogjën SOPIN nuk u shfarosën të tërë juve të PRERËVE. Kurse mua mu afrua kamerieri dhe më tha:

- Mos ua vendo veshin, nuk janë trima, ashtu sillen me të gjithë ne, që s'jemi të këtij fshati, përherë janë të dehur, janë përpara vdekjes, dhe akoma s' kanë formuar familje.

Unë iu falënderova shoferit...?!

P Ë R G J I M E T

Ishte koha kur për një telefonatë pritnim me orë të tëra, ose të kishe ndonjë mik në postë, por ishte shumë vështirë, pasi ne shqiptarët assesi nuk vinim në rend, për tu punësuar në ato vende pune. Për një numër telefoni kishte biznesmenë, që jepnin para të majme, por deri te numri assesi të vinin. Dëgjonim se tek tuk jepej ndonjë numër. Dorën në zemër për atë kohë ishte luksoz dhe privilegj të kishe telefon në shtëpi, e veçanërisht për ato persona, që merrnin numra a nuk u nevojiteshin aq shumë, sa atyre që i përmenda më lart.

Unë si gjithë moshatarët, mbytesha me hallet e jetës, dhe assesi të mbërrinte rroga për tërë muajin. Ato pak dijeni që i kisha nga lënda e ELEKTROTEKNIKËS me ELEKTRONIKË, por më tepër nga skamja. Shpeshherë televizori, që e kisha dhuratë nga martesa prishej disa herë në javë. Si e siguroja HAVINË tërë të dielën merresha me ndreqjen e tij. Edhe ajo e diel më kaloi me ndërrimin e disa llambave dhe disa përmirësimeve të vogla. Si e mblodha televizorin dhe fillova ti rregulloj kanalet, ishin shumë pak, por më tepër më interesonte ai kanal ku e kapsha TELEVIZIONIN SHQIPTAR, kuptohet se e mbyllnim derën dhe i vendonim perdet, sepse siç

thotë populli ”FUSHA KA SY, KURSE MALI KA VESHË”, dhe mundej ti haja disa vite të mira burg. Kur do të dilja do të shpallesha HERO, ose dikush tjetër do të më shpallte, kurse unë kurrë s’ kam bërë dhe s’ bëja punë, që ta meritoja atë EPITET.

Përnjëherë dëgjova një zile telefoni. U habita, telefon në shtëpi nuk kisha. As fotografi televizori s’ kishte, por më fillova të dëgjoj bisedën e lidhjes. U folën shumë fjalë të MËDHA dhe EMRA. Disa prej tyre edhe i njihja. Një pjesë të bisedës e dëgjoi edhe gruaja, por ajo nuk i vendoi shumë rëndësi sepse nuk është prej këtij rrethi, dhe nuk njihte asnjë emër prej atyre që u përmendën. Unë si ia sqarova bisedën kërkova edhe mendimin e saj, a të shkoj te ai shoku që emri i tij u përmend disa herë. Gruaja nuk dha asnjë mendim, më la që të vendosja vet.

Rastësisht në qytet takova kushëririn. Duke pirë kafen ia sqarova krejt ndodhinë, dhe kërkova edhe mendimin e tij. Ai u pajtua se do të ishte mirë që ta lajmëronim personin, dhe ai do të shfrytëzonte rastin që të takohej me të, as që kishte dëgjuar se kishte dalë nga burgu, pasi ai përpara disa ditësh ishte kthyer nga kurbeti.

Shoku na priti shumë mirë, unë i thash:

- Sot jam në shtëpinë tënde me një MISION SEKRET, ashtu mendoj unë, dhe se është HUMANITAR. Shoku pak u habit, dhe tha:

- Sido që të jetë, ju përherë jeni të mirëseardhur në shtëpinë time, por besoj se edhe unë në shtëpinë tuaj. Unë si e dëgjova me shumë vëmendje bisedën, prapë e mora fjalën:

- Prapë do të them se është sekret, unë dyshoj për këtë kohë, çdo bisedë mundet të jetë edhe ndonjë KURTH, por jo prej SHOKUT, MIKUT dhe ndoshta edhe prej KOLEGUT. Unë nuk dyshoj në sinqeritetin e atyre që bisedonin dhe që u thanë ato fjalë, por vallë nëse unë kap asi bisedash me atë televizorin tim SHKATRRAQ, atëherë çka ngelur për organet POLICORE. Unë të them, bile edhe të lus, sot për në ora tetëmbëdhjetë e lanë të bisedojnë; për PUNË edhe më të MËDHA dhe më me PËRGJEGJËSI. Prandaj ju kisha lutur të vini në shtëpinë time dhe në orën e caktuar të DËGJONI BISEDËN, dhe të bindeni se televizori im s' ka KURRËGJË më TEPËR se televizorët tjerë.

Ne dolëm kurse shoku premtoi se në kohën e caktuar do të vinte në shtëpinë time. Unë bashkë me kushëririn e kyçëm televizorin dhe deri në minutën e fundit pritnim, që të vinte personi, por ajo nuk ndodhi. Fiks në orën e caktuar, ra zilja e telefonit. Personi nuk erdhi, por e kishte kryer punën. Zonja e cila ishte këndej i tha:

- Mos flisni asgjë se SPIUNËT SHQIPTARË na kanë parë në televizor. Ai prej andej nuk la fjalë BANALE dhe të PISTA pa thënë.

Me shkatërrimin e sistemit një partiak, kur më në vendin tonë ishte formuar edhe PARTIA e JONË SHQIPTARE, dhe kishim disa deputetë në Parlament mendonim dhe mendojmë se më mirë, dhe më lehtë do të frymojmë. Atë e dëshmoi, dëshmon dhe do ta dëshmojë koha, për fat deri tash për të KEQ.

Pas një kohe rastësisht atje në Bit Pazar u takova me disa shokë, dhe u ulëm në një kafene, për të pirë kafe dhe pak të pushonim. Nuk shkuan shumë minuta andej kaloi një person, që unë nuk e njihja personalisht. Ato shokët e thirrën dhe ai u ndal dhe u ul që edhe ai të pinte një kafe. Biseda ishte mjaft e mirë dhe konstruktive. Unë vetëm dëgjoja, me të vërtetë PUNËT e MËDHA, bëhen nga njerëz të mëdhenj, por edhe në qendër, QYTET e jo nëpër fshatra, apo vende rurale, siç u thonë në kohën e fundit.

Mua gjatë bisedës disa herë nëpër kokë mu soll ai rasti i bisedës telefonike nëpërmes televizorit. Disa herë u mata t' ua tregoj por nuk më jepej rasti. Njëri nga të pranishmit tregoi një rast përafërsisht të njëjtë, kurse ai kalimtari, DEPUTET tregoi se ishte ekspert për atë fushë, prandaj edhe unë mora guximin që të kyçem në bisedë. Ua tregova krejt rastin, kurse deputeti dëgjonte me shumë vëmendje. Ky rast dukej se i ishte për të pranishmit si i veçantë, dhe UNIKAT. Deputeti vetëm më pyeti:

- A ishte kanali KATËRT?! Unë iu përgjigja me po. Atëherë deputeti tregoi si ekspert që ishte për atë fushë, se kanali i katërt ka qenë i lidhur me telefonat privat, por ndoshta edhe me ato shtetëror dhe krejt bisedat kanë qenë të INÇIZUARA e veçanërisht bisedat e shqiptarëve. Me PËRGJIMET qëllimi i pushtetit të atëhershëm ndoshta edhe ky i tanishmi ka qenë, dhe është, që të ketë sa më shumë; BURGOSJE, PËRÇARJE dhe VËLLAVRASJE ndër shqiptarë.

AUTODIDAKTËT

Duke lexuar gazetat, atje ka faqja e parafundit me germa të mëdha lexova KONKURS. E lexova disa herë prej në fillim e deri në mbarim. U binda mirë, se ai konkurs përgjigjet për kualifikimin tim. Por edhe s' ishte me orar të plotë pune, për mua si përtac që jam, ishte i mirëseardhur.

Të nesërmen qysh në mëngjes fillova të kompletoj dokumentacionin e kërkuar. Ç' është e drejta kishte afat gjashtë ditë, dhe dy ditë jo pune, ato bëjnë tetë, por sot nuk i dihet në është njëri nëpunës s' është tjetri, ose mundet të jetë e tërë java festë fetare, duam apo s' duam ne ky është SHTET BIBLIK, por ndoshta për disa mundet të jetë edhe festë shtetërore.

Tërë javën bëja edhe planet ku dhe si do ti harxhoja ato para. Më në fund mu kujtua, që ti jepja për BAMIRËSI, të gjithë do të më shpallnin si njeri të mirë, bile edhe njeri të MADH si ato artistët e HOLIVUDIT.

Ditën e fundit kur mbaronte afati i konkursit, unë e kisha gati të tërë dokumentacionin, dhe si i futa në një zarf, u nisa në drejtim të postës. S' di pa dashtë dhe pavetëdije duke shkuar rrugës i kam përsëritur planet për harxhimet e parave, edhe atë me zë. Përpara se të arrijë te posta dhe të bëja postimin, dikush më

kapi për krahut të djathtë. Unë ktheva kokën dhe pash dy persona. Ai që më kapi për krahu më tha:

- Të lutem ma jep hisen time. Unë jam njëri nga ato. Unë u habita, sa shpejt fjala e mirë, apo premtimi shkon në veshin e njerëzve nevojtarë. I habitur e pyeta:

- Më falni, ju kush ishit?! Ai gjithë qejf tha:

- Unë jam DEPUTETI i zonës. Ju duke ecur disa herë thatë se paratë do ti ndani në katër pjesë! Unë pohova me kokë. Atë se ndal as topi. Njërën pjesë i thash TY si deputet zonë, një pjesë, KRYETARËVE RURALË dhe pjesë tjetër do ta harxhoj me KRYETARIN e SHSHM-ës edhe atë duke zbrazur shtambat me verë te RRAPI, atje matanë KISHËS që është në ndërtim prej parave të njerëzve të mirë. Bile më shumë prej parave të atyre që kurrë s' do të hynë aty të luten, por ATO të atyre bëhen sikur s' duan që ajo të ndërtohet, kurse disa herë, atje ku duhet kanë bërë AMIN bile edhe AMEN.

Ja shikoni, tani shkoj në postë të bëjë postimin, të bëhen të gjitha formalitetet, të punoj tërë muajin, të kalojnë edhe ato pesëmbëdhjetë ditë nga muaji tjetër, siç tha ai i JUAJI, ti marr ato para, e pastaj t' ua shpërndajë juve, por edhe atyre, por edhe unë me kryetarin e SHSHM-ës të kënaqem aty te RRAPI duke zbrazur KUPA, bile ndoshta edhe...?! Deputeti i revoltuar më tha:

- Zotëri këtij premtimit tënd populli i thotë “ PRIT MAGJAR TË MBIJË BAR” Si i dëgjova këto fjalë të zotit deputet, ashtu qetë i thash:

- Ju duhet ta dini se këtu ka LIGJE dhe rregulla, që i keni sjellë JU, por ka dhe zot të këtij SHTETI, apo siç i thoni ju atje në PARTALLMENT se ashtu e quan baca Salë Kërçova është VEND BIBLIK, këtu lindin MREKULLI të ÇUDITSHME. TERAKU ngjyrë SKEMJEJE i venduar aty në afërsi të shtëpisë së Nënës Terezë për të cilin janë harxhuar mjete më tepër se sa për njëmijë studentë, s’ di a të them studentë shqiptarë, apo një mijë punëtore të falimentuar. Ai personi tjetër që tërë kohën heshte dhe nervozohej, ajo nervozë shikohej nga ngjyra e fytyrës, më në fund edhe ai u kuq, duke më thënë:

- Më duket se keni qëllim të mirë, por veprimi është i KEQ. Unë sa dëgjova ju doni të ndihmoni dhe të bëni bamirësi. Ju këto para që i jepni për këto njerëz, mua më duket, jo që s’ bëni bamirësi, por ndoshta bëni edhe mëkate. Unë u habita dhe i thash:

- Hajde trego si bëhet bamirësia. Ai duke shikuar deputetin e zonës ia nisi:

- Ju me siguri keni dëgjuar se vinë njerëz prej Turqie, dhe këtu japin darka-iftare, edhe atë disa qindra, ndoshta edhe mijëra, ajo është bamirësi. I thash në rregull, por ti dhe ato a e dini sa ditë ka viti?! Ç’ bëjnë ato skamnorë vetëm me një darkë apo drekë vjetore?! Prandaj unë ua jap atyre që kanë, ta jetojnë

atë pak jetë tamam si ato që i majmë tërë verës, dhe kur afrohet dimri, e dini ç' dua të them, ua bënë ai xhaxhi zot i SHTETIT BIBLIK, por me ndihmën e atyre ZOTULAVE shqiptarë. Që dikur janë shkolluar me plotë taksa, pa bukë, bile edhe pa ujë të mjaftueshëm, por për kolltukun e butë, shpejt kanë harruar dhe sillen ashtu siç u thotë padroni dhe shpallin konkurset përfitues të MO-ës.

A e dini ju kur mbaroi MO-ja ai xhaxhi me plot gojën KOMB, para gazetarëve dridhej e përdridhej, kur ne i duartrokitnim, kurse ai më ish dhëndër ynë i tha:

-Mos u dridh e përdridh, për FITORE more HALLDUP AUTODIDAKT si ato të fazës së PUBERTETIT, ti dhe ato të tuat, por dhe të tjerët se kuptuat, se NE këtu te BILJANA e BUKUR, por edhe te ARENAT "MIRË UA FUTËM". Pas pak kohe te gazeta FLAKA, një autor botoi POEZINË:

LIHNIDA PARTALL NË SHKOP
Kokat të ngulura në hunj pas shpine
Shikonin gjymtyrët e ndara nga trupi
Dhe sytë e skuqur për pushtet të kalbur

LIHNIDA PARTALL I BARDHË NË SHKOP
Me kataroshët që kënaqen me tul fëmijësh

Duke rrëmbyer tinëzisht fjalën e shtrenjtë KOMB...?!

Plaku i urtë xha Biti si e lexoi mirë e mirë disa herë poezinë, por edhe shumë shkrime të gazetave të asaj kohe për MO, e zgjidhi shaminë e kuqe gjak, që e mban për brezi, prej atëherë kur me atë shami ia kishte fshirë dhe lidhur plagët vëllait të vrarë për LIRI, së bashku me poezinë e lidhi te shkopi i pleqërisë me kërrabë dhe përmes ÇARSHISË, këndoi këngën:

Hënë e re. Hënë e vjetër. Me MO-në. Robëri e luftë tjetër....

PROFESORI I GOLI OTOKUT

Muaji i dytë apo i tretë nuk më kujtohet mirë, cili ishte që kisha filluar të punoja në atë organizatë, por mirë më kujtohet, sa kisha hyrë në zyrë dhe kisha filluar të shfletoj gazetat e ditës. Ra telefoni, e hapa, prej andej sekretari i organizatës, me një ton të ashpër dhe urdhërues, më tha shpejt të isha në zyrën e tij. Si i lexova krejt titujt e Flakës së Vëllazërimit të atëhershme, u nisa për te sekretari. Sa e hapa derën, më shikoi dhe më tha:

- Shpejt ma sjell librezën e Lidhjes Komuniste. Unë iu përgjigja se nuk e kuptoja çfarë libreze kërkonte. Ai me shumë seriozitet, prapë i përsëriti fjalët e pak më para. Unë gjo i habitur, por serioz i thash:

- Unë as që jam anëtarë i asaj lidhjeje. Sekretari e çoi kokën dhe më shikoi me një seriozitet të egërsuar, dhe tha:

- Si është e mundur një person që ka punuar në arsim të mos jetë anëtar i Lidhjes Komuniste?! Edhe unë me shumë seriozitet i thash:

- Nuk e di si është e mundur, por e di se unë nuk jam, dhe as që do të jem. Atëherë ai edhe më me egërsi më tha:

- Ja ku e ke letrën dhe bëre LUTJEN, ose shkruaj ARSYEN, pse nuk dëshiron të jesh anëtar i LKJ. I

thash se unë nuk shkruaj as njërën e as tjetrën, por të them, se tash për tash nuk jam i gatshëm, sepse ajo është diçka shumë me VLERË me PËRGJEGJËSI dhe SERIOZE, kurse unë nuk jam njeri i tillë, dhe dola prej zyre.

Kaluan disa muaj, Organizata e jonë bëri një kontratë më Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit, për ti shitur një sasi mjaftë të madhe të KROMIT. Dhe unë si i vetmi shqiptar i punësuar më angazhuan të jem edhe si përkthyes. Gjatë asaj kohe rashë në kontakt me KIMISTIN e organizatës sonë. Ishte mjaft plak, ai më tregoi se shumë herë kishte dëgjuar, për refuzimin tim që të mos bëhem anëtar i LKJ-ës. Kimisti më tha se edhe ai nuk ka qenë dhe nuk është anëtar i LKJ-s. Po ashtu më tha se sekretari do të insistojë, por unë duhej me këmbëngulje ta refuzoj, por të kem kujdes se është njeri shumë i rrezikshëm. Dhe hiç pa droje më tha:

- Sa të cofi ai që e mbajnë të varur nëpër zyra, ky shtet do të SHPËRBËHET. Por edhe shumë fjalë të tjera, që për atë kohë ishin mjaftë të rrezikshme, e veçanërisht për mua si shqiptar. Dorën në zemër unë as që i besova, dhe më shumë e mora si provokim. Prej atëherë i iksha sikur bisedës, por nga të punësuarit tjerë dëgjova se ai nuk ka kurrgjë përveç gruas, dhe se ai përveç që ishte kimist i diplomuar, përpara ka pas të kryer fakultetin teologjik.

Investimet e huaja harxhoheshin pa kontroll. Disa herë me njërin nga drejtorët, që ishim edhe moshatarë dhe të dy kishim punuar në arsim, diçka na afronte dhe për shumë gjëra na përputheshin mendimet.

Në fillim të javës, kur arrita në punë, në tabelën e shpalljeve lexova. Të mërkurën do të mbahej mbledhja e Lidhjes Komuniste, kurse të premten, do të mbahej Tubimi i punëtorëve. Rastësisht unë ashtu mendoj, u takuam me kimistin, dhe ai më tha:

- Sot, me siguri do të thirri ai pabesë, apo siç i thoni ju KAURI. Unë qesha dhe vazhdova rrugën.

Vërtetë, pas hajes së mëngjesit më thirri sekretari dhe ashtu me urdhër të prerë më tha që ta nënshkruaja lutjen që ai e kishte përpiluar vetë. Unë jo vetëm që e refuzova, por edhe e grisa lutjen, dhe u nisa të dalë prej zyre. Kur arrita te dera, sekretari i revoltuar tha se do të hakmerrej. Unë duke mbajtur bravën me dorë i thash se do t' ia thyeja edhe këmbën tjetër, nëse bënë zë.

Të premten mbledhjen e mbajtëm te salla e Pallatit të Kulturës. Pati shumë biseda të nxehta, foli edhe kimisti, por për mua bisedë më e nxehtë ishte ajo e atij plakut, që unë e shikoja përherë të parë. Ai si i tha disa fjali shumë me vend dhe me një stil të lartë, në fund tha:

- I nderuari drejtor, djalë i im, faji s' është te ju, faji është i imi dhe i EPRORIT tim. Kur e pata në

dorë, EPRORI nuk më la ta thersha si DERR DOSE, atë që është i varur mbi kokën tënde-TITON.

Pas disa ditësh me të njëjtin drejtor shkuan në një udhëtim zyrtar. Gjatë rrugës, drejtori më pyeti:

- Si tu duk profesori i Drazhës?! Unë i thash se nuk di për cilin e keni fjalën! Drejtori ashtu serioz më tha për plakun që foli në tubimin e punëtorëve. Unë si habitur e pyeta:

- Vërtetë kush ishte ai, mu duk mjaftë në moshë, por shumë inteligjent. Atëherë drejtori më tregoi se ai është një profesor filozofie i cili ka qenë në Kabinetin e Drazha Mihajlloviqit. Si kam erdh unë në këtë ndërmarrje e kam pranuar, që të bëjë pak stazh pune dhe të dali në pension, nëse arrin pasi i ka mbushur të shtatëdhjetat.

Disa ditë më vonë i thash shoferit, që të gjejë pak kohë, dhe shkak ta vizitonim profesorin në vendin e punës. Ai më tha se po të isha unë i lirë mundej menjëherë të niseshim.

Prej te rruga ku e lamë Landroverin duhej të ecnim nëpër baltë së paku një kilometër. Prej larg e pamë profesorin duke thyer gurë me një tokmak disa kilogramësh. Unë u afrova e përshëndeta, edhe ai më përshëndeti. Biseduam disa minuta, profesor s' ndalej duke thyer gurë, unë i thash ndalu, merr një frymë. Ai më tha puna s' është e rëndë dhe se shumë mirë ndihej në mesin e njerëzve të mi. Dhe se kishte biseduar me popin-kimistin për mua dhe refuzimin që të bëhem

anëtar i LKJ-ës, dhe se mirë kam vepruar. Aty më tregoi se POPI pas lufte paska hekur të zezën e ullirit, Titoja e paska TREDHUR e ka lënë pa familje, kurse atë e ka dënuar me pesëmbëdhjetë vite burg në Goli Otok, ku ka pasur edhe shumë shqiptarë.

Edhe profesori mi tha fjalët e popit-kimist: ” Pas cofjes së Titos, ky shtet do të SHPËRBËHET ”. Kurse ai në shpirt kishte një plagë dhe një hidhërim ndaj EPRORIT të dikurshëm, që nuk e ka lënë t’ ia priste kokën si DERRIT. Nuk di ç’ do të thoshin profesori dhe popi-kimist për OAZËN dhe GOLI OTOKUN e ditëve tona...?!

TRIUMFI

Nuk ka njeri në këtë botë, që i dëshiron, vetvetes dhe fëmijës së vet të jetë; fukara, i sëmurë, anormal, i pa shkolluar dhe shumë e shumë të meta të tjera. Por ajo nuk varet krejt nga vetë individit, sepse ashtu ndoshta ia ka përcaktuar fatin i LARTË MADHËRISHMI, por shpeshherë edhe faktori njeri.

Në sektorin që e udhëhiqja i kisha dy persona total me të meta mentale. Nëse u thoshe të mbushin ujë, ato do të çanin dru, nëse u thoshe të fshinë, ato do të thoshin se duhej të shkonin në shtëpi, apo diçka të ngjashme, por edhe ato duhej të jetonin. Arsyeja e punësimit të tyre ishte, Organizata ua kishte marrë, atë pak tokë, të klasës së pestë, të gjashtë, por ndoshta si takonin asnjë klase. Edhe në sektorët tjerë kishte prej atij lloj njerëzish.

Në bisedë me drejtorin në lidhje me ato persona, ai mi përsërit fjalët e lartë përmendura. Mu dha rasti ti them se edhe mua më është marrë disa herë më shumë tokë se atyre, dhe toka ime është shumë më e mirë. Kazani me avull i Termoelektranës është i ndërtuan në tokën time, por unë dhe shumë bashkëfshatar nuk i kemi, dhe nuk i gëzojmë këto privilegje. Drejtori më shikoi e thithi thellë tymin e cigares, e piu gllënjkën e fundit të rakisë, dhe në dorë e kapi filxhanin e kafesë,

dhe prapë e thithi thellë tymin e cigares, dhe pa shkrepit sytë më tha:

- Atë që thatë ju është e saktë. Por ju dhe njerëzit tuaj, nuk ia keni parashtruar shtetit ato kërkesa dhe kushte, që kanë parashtruar këto të mitë. Më kujtohet mirë kur ato TRE PERSONAT e juaj, dhe mi tregoi me emër e mbiemër, që mirë kanë qenë të kripur u kanë thënë, ato të vazhdonin punët, kurse ato TRE do të merren veshtë me pronarët e tokës, që do tu merret, frikën do t' ua shtinë deri në palcë. I thash ajo ka qenë e vërtetë, ju aspak nuk gënjeni, se njëri prej atyre, babës tim i është kanosur me burgim, dhe dajak nëse nuk pranon, për një metër katror të marri aq para sa të blen një, bile edhe më pak se një pako cigare prej atyre më të këqijave. Ju më tha drejtori jeni njerëz të çuditshëm, për vetveten jepni tërë KOMBIN, kurse ne për KOMBIN japim vetveten, por më të flaktë për SHTETIN dhe KOMBIN janë serbët. Dhe përmendi disa raste të Kosovës, në mesin e tyre edhe atë të Martinoviqit, me shishen e koka kolës. Prandaj ne dhe ato e kemi shumë lehtë me ju. Kripi mirë jepu kolltukë disa personave tuaj, dhe krejt punët do të shkojnë sipas qejfit. Unë tha kam mundur të ngel në punë atje, por me marrëveshje, që rroga dhe disa punësime të jenë sipas qejfit tim, ndodhem në këtë ndërmarrje. Ti shumë sekrete nuk i dinë, se ke punuar në arsim, siç nuk i dija edhe unë kur punoja në shkollën e mesme të xehetarisë. Në arsim nuk ka

DALLAVERE, por në prodhim dhe në politikë ka sa të duash. Unë duke qeshur i thash:

- U binda se ju bëni dallavere, por a do të mundem edhe unë të bëjë, si ju dhe ato tre shqiptarët e NDERSHËM, me pronat dhe të DREJTAT e vëllezërve të vet. Unë tha nuk e di, por ti dhe drejtori i INVESTIMEVE të huaja i keni duart e zgjidhura!

Nuk shkoi shumë kohë më lajmëruan se të nesërmen me dy persona të tjerë do të duhej të marrim pjesë në varrimin e një punëtori i cili kishte ndërruar jetë në njërin prej reparteve ku unë përpara pak kohe isha zgjedhur Kryetar Sindikate. Të nesërmen prej në mëngjes landroverin nuk e pash të parkuar, por çdo moment e prisja shoferin të paraqitej në zyrë dhe të niseshim. Aty ka ora dhjetë e diçka erdhi shoferi i veturës luksoze dhe më tha se ishte gati për tu nisur.

Mbërritën në kohë, dhe u ndalëm derisa mbaroi ceremonia e varrimit. Si u përshëndetëm me shumë punëtorë të atij reparti dhe fshatarët unë me dy personat, dhe përgjegjësin e repartit shkuam, në shtëpinë e të ndjerit, që të takoheshim me familjarët tjerë më të afërt. Duke i pirë kafet, edhe meqenëse ne nuk deshëm, por ato na i sollën, unë pyeta për fëmijët e të ndjerit. Përgjegjësi i repartit, punëtor mjaft i dalluar dhe bashkëfshatar i të ndjerit më tha se djali më i madh ishte ai përballë meje, dhe se përpara dy muajsh ka mbaruar tetëvjeçaren dhe atëherë i ka mbushur plot pesëmbëdhjetë vjet. Përpara se të

largohemi i thash përgjegjësit, që të mendonte një vend pune për djalin, kurse atij i thash, pasi ti bënin rendet të vinte në zyrë te unë dhe të fillonte me punë. Djali dhe disa të afërt u falënderuan, kurse përgjegjësi duke u përshëndetur më tha:

- Mos u ngute, djali është shumë i ri, ç'do të thonë atje poshtë. I thash ti mos u mërzit. Rrugës edhe shoferi më tha se do të jetë vështirë, por edhe atij i thash, që ai të mbante timonin dhe të heshtte.

Dorën në zemër disa herë natën më vajti mendja te i ndjeri, dhe premtimin që bëra, për sukses, por më shumë për jo sukses. Të nesërmen sa mbërrina në zyrë dhe fillova të shfletoj gazetat e ditës, njëra nga koleget ma solli kafen e mëngjesit, dhe pas saj menjëherë në zyrë hyri Drejtoresha kadrovike dhe kërkoi që edhe asaj ti bënte kafe, por zonja i tha, asaj nuk do ti jepte helm e jo kafe. I thash, shumë mirë i thatë, por bëja një kafe ndoshta erdhi me detyrë, ajo qeshi dhe u ul përballë meje.

Duke e pirë kafen më pyeti si kaluam dje, i thash mirë si në varrim, me siguri, ua kanë marrë sihariqin. Zonja që i bëri kafe tha se ata dhe ajo, të krejt janë spiunë. Drejtoresha shumë serioze tha se djali qenka shumë ri, dhe se s'mundet të bëjë asnjë punë. I thash me siguri do të bëjë më shumë punë se ato të asaj e veçanërisht ai kushëriri i vet. Pa mos e pirë deri në fund kafen, doli prej zyre.

Nuk shkuan as dhjetë minuta e hapi derën dhe si e çmendur më tha që të shkoja me atë te drejtori, dhe fjalët që ia thash asaj t'ia them edhe drejtorit. I thash, ti shko unë do të vite, dhe do t' ia them të tëra fjalët bile edhe më tepër, se sa i kam thënë asaj. Kurse zonja i tha:

-Çfarë ushunjëze je tiiii. Pas dy a tre minutash edhe unë shkova. E përshëndeta, edhe drejtori më përshëndeti dhe e uli kokën sikur lexonte diçka, kurse USHUNJËZA siç i tha ajo zonja filloi t'ia sqarojë ndodhinë. Drejtori pa mos e ngritur kokën më pyeti si kalova, edhe atij i thash, mirë si në varrim, plotë dhimbje. Drejtori e çoi kokën dhe më pyeti:

- A është e vërtetë, kjo që thotë drejtoresha?! I thash se po, ai edhe njëherë më pyeti, a është e vërtetë, unë më i vendosur, prapë i thash se po. Atëherë drejtori shumë i vendosur dhe shumë serioz tha:

- Ka marrë fund, edhe unë të isha, ashtu do të veproja, të lumtë. Drejtoresha e hapi SHPELLËN, por drejtori i tha të hesht, ajo është punë e tij dhe e imja, dha assesi e saj...?!

MREKULLIA E SHEKULLIT

Gotën e lëngut që e mbaja në dorë, dhe pak më parë e kisha shijuar, më kthehu shumë vite mbas. Më saktësisht në gjysmën e viteve, që i kam tash, por duke e minusuar edhe me gjysmën e numrit të parë dyshifror. Atëherë kur isha mysafirë në shtëpinë e madhe dhe të bukur të Sekretarit të Lidhjes Komuniste, në qytetin e madh ku kishte lindur PAPA i atëhershëm. Nikoqiri krenohej me Papën dhe sa herë, që e përmendte emrin e tij në kraharorin e vet bënte kryq, kurse unë habitesha, si mundej një komunist, edhe atë i përbetuar të bënte atë rit fetar. Zonja e madhe me zonjushën e vogël, krenoheshin me dhuratat, që disa herë i merrnin në dorë, disa herë i lenin mbi kanape, dhe herë njëra herë tjetra i merrnin çelësat e veturës me zero kilometra, që zotëriu e kishte DHURATË, nga shteti më i madh dhe më i fortë KOMUNIST në botë.

Si i shikuam fotografitë e albumit më të rinj, më tha se do ta sillte shishen e verës "KUMIS", që e kishte dhuratë të rrallë, nga vizita e fundit nga vetë sekretari i LK-ës të kryeqytetit. Dhe filloi të më tregojë, se në pusullën e shishes shkruante për përbërjen. Përveç të tjerave kishte edhe qumësht PELE të stepave ruse, unë dorën në zemër as që kisha dëgjuar ndonjëherë për atë pije, dhe se qumështi pelës

përdorej për asi farë pijeje apo vere, dhe se ishte aq i dobishëm për shëndetin e njeriut. Kurse unë e dija se në fshatin tim të lindjes, në çdo kohë kishte nga dy apo tri pela të pjella. Pas një kohe bile tash shpejt më është kujtuar, kur isha në shkollë fillore, një shok klase më pat thënë, se kur e ka pasur FRUTHIN i kanë dhënë tëmbël pele, apo gomarice nuk më kujtohet mirë.

Edhe dita e djeshme ishte si dita e atëhershme, me plotë vranësira, dhe shumë e papërshtatshme për shëndetin tim, por lëngu i bardhë, që e bëri zonja me aromë dhe shijen e bukur tamam si KUMISI i dikurshëm i rezistonte Astmës, mikeshës së mbrapsht, që e mbajë si zonjë me tërë të mirat e Zotit, më tepër se gjysmën e viteve që kam, por tash duke ia shtuar edhe numrin e parë dyshifror dhe prapë s'është e kënaqur, si damat e shtetit biblik.

Ecëm, ndoshta i bëmë mbi dy kilometra, por nuk gjetëm asnjë titull shqip, krejt ishte pastër si loti, ORTODOKSE-SLLAVE. U takuam me disa miq të vjetër, por të vendit se nga jashtë kufirit biblik, as që kishte njeri, dhe më shumë na befasoi ajo mungesa e veriut, se i kanë vëllezër dhe motra nga baba, se nga nëna, siç tha dikur ai funksionari shqiptar nga perëndimi, tash më i ndjerë, ndjesë pastë; të gjitha nënat e atyre janë....?!

Unë si atëherë edhe dje, arrita ashtu i pa vetëdijshëm te URA, që dikur më çonte te ORA e

ndalur herët në mëngjes. Por atëherë në dorën e djathtë mbaja atë LIBRIN HALLALL, kurse në dorën e majtë atë tjetrin, që për NE dhe mua është HARAM. Të dy i bleva me kuaj të kuq, dhe në xhep ngela pa asnjë kalë. Atë halla edhe pse ishte mbështjellë me dy qeska najloni e futa nën sqetull dhe dorën e futa në xhep, që mos e kapte asnjë pikë shiu, kurse për atë tjetrin as që më vajti mendja të kujdesem. Edhe atë e mbështolla mirë, por jo se ishte me vlerë, dhe frikohesha prej ATIJ lartë, por të mos ma shikonte dikush prej atyre, që pëlhurën e bardhë savan e mbajnë të mbështjellë për kësule, por jo me qëllimin e atyre të anës së Rugovës, si ka mbetur ai adet, në atë profesion unë nuk e di pasi nuk jam ekspert për atë lëmi.

Aty mbi urë dëgjova disa zëra, por si kuptoja prej ku vinin. Prej rrjedhës së ujit, apo prej te duart e mija. Qartë dhe mirë dëgjova se dikush më tha:

- Shikoje mirë ujin nën urë, ai vjen prej shumë larg, kurse ti ku je është ai RRETHI, që e kanë zbuluar ato të dorës tënde të djathtë. Unë kam lind atëherë, jam rrit dhe zhvilluar aq shumë sa ju asnjë nuk dini, a ti më mban në dorën e majtë, si pa vlerë, ajo është e drejt e juaj. Ato që e zbuluan ngelën aty ku janë me atë rreth, dhe dikur lindi ai që ti e mban në dorën e djathtë, që unë nuk e nënvlerësoj, por ato që iu bashkëngjitën ATIJ e keqinterpretuan dhe ngelën aty ku ishin...?!

I thash se krejt është në rregull, por unë të kthehem atje ku isha. Siç përmenda atje u takova me disa zotërinj, dhe me njërin u afruam te një i njohur i tij, i cili shiste libra me nam. I thash ta jap edhe unë një të imin edhe pse nuk jam njeri me nam. Ai e mori librin në dorë e shikoi pak si gjatë, dhe pastaj më pyeti:

- A vetëm shqip është?! Unë i thash ashtu është siç e shikoni ju. Atëherë ai më tha eja pas meje, dhe drejt te disa mjekërosha. Mori një libër dhe ma dha duke më thënë:

- Shikoje mirë, dhe ta kesh, dhe ta keni si model, për veprat tjera. Unë e shikova, vërtetë kishte fjalë shqipe, por edhe një gjuhë tjetër. Plotë germa të thyera, të shtrembëruara, plotë pika, që unë si kuptoja. E pyeta :

- Këto germa të kujt gjuhe janë?! Ai me mjekrën e përjargur, më shikoi dhe ashtu, shpejt e shpejt tha:

- Ata germa janë të atyre që se PRANOJNË, Kosovën, dhe as që do ta pranojnë ndonjëherë. Mirë thash, Ju shkoni atje në HAXH dhe ndoshta thotë Zoti faroheni, por cila gjuhë është kjo te ky libër?! Ai, prapë ashtu i nervozuar tha:

- Turp, kjo është ajo gjuha që e kanë folur heronjtë. Zonja që ishte aty afër tha:

- Tash ekspertët përpilojnë MREKULLINË E SHEKULLIT. Çdo grua apo burrë shqiptar do të duhej të ketë edhe një grua, apo një burrë tjetër, siç

janë edhe librat e këtyre mjekroshëve, ose do të jenë, bile edhe janë librat shkollor në gjuhën shqipe. Tash, thash e kuptova, por a pajtohesh Ti me të?! Biondja tha:

- Unë jam pajtuar përpara atij që ti e përmende, dhe tash është i ndjerë, së bashku me partnerin e vet të koalicionit të atëhershëm-Titon. I thash shumë në rregull e kuptova, por cila gjuhë është në këtë libër së bashku me gjuhën time?! Ai prapë edhe më i nervozuar, por tash duke i fshirë jargët, me siguri iu shijua diçka, tha:

- Siç më duket ti s' di kurrgjë, as lexon e as shikon televizor. Kjo është gjuha e atyre te filmi "NJË KOMB", që pinë drogë, shkatërrojnë të rinjtë dhe me lezet e hanë mishin e derrit të egër, dhe prapë fshiu jargët...?!

POROTA

Në qendër të fshatit me disa shokë klase bisedonim për provimin e aq të përfolur të semimaturës. Disa arsimtarë thoshin se do të mbahet e të tjerët e mohoni. Kurse neve na kishin ngelur vetëm edhe dy muaj mësim. Njëri nga shokët, pas asaj bisede na tregoi lajmin që e kishte dëgjuar nga babai se pas tri ditësh në qytet do të vinte AVOKATI më me nam në BALLKAN, edhe atë nga kryeqendra e shtetit tonë. Dorën në zemër ne as që dinim për çka shërbente ai titull, prandaj ne e mendonim se ai njeri është si i mbinatyrshëm, kuptohet pas kryetarit të shtetit, të atëhershëm.

Atë ditë së bashku me dy shokë ecëm në këmbë plot dy orë. Dhe mbi një orë pritëm në rrugën kryesore ku do të kalonte avokati. Arriti edhe sekonda e fundit kur ai do të ndodhej përpara nesh. Dikush bërtiti vjen FILLOTA. Ne hapëm sytë në drejtim të tij. Vërtetë ishte ashtu siç thash pak më parë. I veshur shik, në kokë një kapelë me strehë ngjyrë kafeje, në dorë një çantë lëkure, dhe pas tij ecnin disa persona, që e përcillnin hap pas hapi.

Edhe pse i kisha mbushur tri dekada të jetës bile edhe pak më tepër, unë s' kisha hyrë në derë të gjyqit dhe as që do të hyja, sikur të mos kishim një fatkeqësi në ndërmarrjen ku punoja. Sa e kisha hëngër mëngjesi

dhe prisja ta pijë edhe kafen. Dëgjova zhurmë, për dritares pash kalin të mbrehur në një qerre me dy rrota, dhe me shpejtësi marramendëse vinte në drejtim të zyrave të ndërmarrjes. Në jug të barakës kishte një rrugicë të gjerë afër një metër, dhe pastaj një mur të ndërtuar me material të fort. Kali nuk e di pse ishte trembur aq shumë, por e di se duke dashur të kalojë atë rrugicë të ngushtë, pa mos i bërë as dy metra kishte ngelur me njërën shtizë të ngulur në anën e djathtë të barkut. Ne kur dolëm, nuk kaluan as dy-tre minuta kali ndërroi jetë. Menjëherë arriti edhe pronari, kur e pa kalin në atë gjendje, me gojën e hapur dhe të larë në gjak, për faqesh filluan ti rridhnin rrëke lotësh. Por ky nuk ishte dëmi i vetëm, kali kishte dëmtuar edhe veturën e ndërmarrjes, që ishte gati më e mira në qytet. Sa hap e mbyll sytë arriti edhe policia. Bënë procedurën, kurse plakut assesi ti ndalen lotët.

Nuk shkoi as një muaj, mua dhe një kolegut në punë na erdhi thirrja prej gjyqi, që të dëshmonin për rastin e kalit dhe plakut, që unë akoma i kisha përpara lotët, që rrokulliseshin nëpër faqet e tij.

Ishte hera e parë, që isha në sallë të gjykimit. Aty e pash plakun, pa lot, por mjaftë të mërzitur. Në afërsi të tij kishte edhe tre a katër të rinj, që më vonë kuptova se ato ishin praktikant. Dhe po atë ditë kuptova, dhe mësova se përveç GJYKATËSIT, ata personat që ishin në krahun e djathtë dhe krahun e majtë të tij quheshin POROTË.

Gjykatësi më tha të dal te foltorja, tamam si në PARLAMENT. Më tregoi se nëse nuk e them të vërtetën do të përgjigjesha. Si i regjistruan krejt të dhënat, më tha prapë, që të tregoja të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Unë e tregova të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, gjykatësi i habitur tha:

- Ti dëshmove krejt në dëm të ndërmarrjes tënde. Ajo është e drejta e jote. Unë i thash se unë dëshmova drejtësinë dhe vetëm drejtësinë. Dëshmitari dytë nuk tha asnjë fjalë, vetëm tha se pajtohet me atë që thash unë, unë nuk e pritsha atë prej tij. Atë ditë, gjykatësi me gjykatësit porotë plakun e kishin shpallur të pa fajshëm.

Pak përpara se të ndërrojë jetë, plaku këtë ndodhi ia paska treguar nipit-jurist të sa po diplomuar. Pas disa vitesh rastësisht në qytetin me dy Universitete, pas mbledhjes u ulëm në kafene dhe u njoftuam me nipin, që unë nuk e njihja, por as ai, duke pirë kafe dhe pas bisedës së gjatë në atë shoqëri, nipi u falënderua nga zemra, që tash ka titull të lartë dhe përgatit-JURISTA.

Pas një zënkë, në organizatë, drejtorin më tha:

-Ju prapë jeni kundër organizatës ku punoni?! I thash se ashtu thotë dhe e kërkon drejtësia kurse ti nuk e ke dashur, nuk e do dhe as që do ta desh DREJTËSINË, sepse je një komunist i pistë.

Rastësisht dëgjova për konkursin e shpallur për POROTË, si e lexova mirë dhe u binda se i plotësoja

kushtet bile edhe shumë më tepër, e dorëzova lutjen dhe pas dy a tri ditëve edhe dokumentacionin e nevojshëm, pasi atëherë i kisha mbushur dy dekada jetë në pension, dhe më nuk më interesonin diplomat. Isha i bindur se kurrë më s' do të më duhen, por në jetë shumëçka ndryshon, dhe ka plotë befasi.

Dorën në zemër isha i bindur se ato njerëz janë të DREJTËSISË. Dhe unë si një çerek intelektual, kjo fjalë është e MADHE dhe e SHENJTË, unë me mbi dy mijë punime, dhe më shumë se gjysma të jetësuar në më shumë se pesëdhjetë revista dhe gazeta të kohës në të dy shtetet, dhe në të tre gjysmë shtetet, do të kontribuoja për të mirën e popullit dhe asaj shtëpie. Edhe pse dikur ai intelektuali i madh i krijimtarinë time e quajti si SHKARRAVINË. Sepse intelektual i madh na qenka ai i cili s'ka vepra por është në listën e madhe të internetit, edhe atë me emër e mbiemër, me profesionin dhe punën e tij si hero i kryqit sllav.

Ajo është e drejtë e tij. Unë mendova se pas mandatit, por edhe brenda tij do të bëja ndonjë shkarravinë, të asaj natyre. Kaloi gjysma e mandatit, unë s'kisha marrë pjesë në asnjë seancë gjyqësore. Dalëngadalë në trurin tim filloi të NGULITET ajo drejtësia FILLOTIJANE. Pas një kohe njëri prej atyre e zgjidhi zemrën, siç thuhet në popull dhe më thirri. Më kujtohet mirë, u ula në anën e djathtë, të niset ka e mbara. Kalova mirë edha atë plotë tri orë. Prej katër

gjykimeve, tri i anuluam për një herë tjetër, kurse për njërin sollëm vendim, real.

Mendova se më u thye akulli, dhe vërtetë ashtu ndodhi. Pas disa ditësh më thirri edhe një tjetër. Pastaj edhe një tjetër... Unë më u binda se aty ishte ajo DREJTËSIA FILLOTIJANE, apo siç thuhet në popull " Paraja e çon ujin në hava". Ajo bindje edhe më shumë u vërtetua, kur për një vit stazh porote i mora njëzet euro. Një shok tash i ndjerë më tha, se ato, prej meje paskan pritur shumë më shumë, bile edhe mrekulli.

Aty ka gjysma e mandatit, njëri prej atyre mu ankua duke më thënë:

- Po të ishte gjallë Titoja do të kisha edhe dy herë më shumë rrogë se tash. Unë iu përgjigja:

- Po të ishte Hitleri i gjallë, unë si arsimtar do të kisha tri herë më tepër rrogë se ti. Krejt ju shkatërroni ose lumturoni një person, ose një familje, kurse ne shkatërrojmë ose lumturojmë tërë gjeneratën, prandaj për arsimtarët përherë ka qenë litari në qendër të qytetit...?!

VESHKAT E KALBURA TË GJENERALIT

Dhimbjet ishin aq të forta, sa që isha i detyruar një orë pas mesnate të shkoja në Qendrën urgjente. Mjeku si bëri kontrollin me tha, me doemos të nxirrej dhëmballa e prishur. Unë s' kisha rrugë tjetër, vetëm se të pajtohesha me fatin. Mjeku si ma dha gjilpërën u largua në dhomën tjetër. Unë ngela i ulur në karrigen stomatologjike. Motra bënte punët e veta, dhe herë, herë më shikonte. Pas marrjes së gjilpërës dhimbjet filluan të qetësohen, por edhe nofulla filloi të mpihet.

Mjeku erdhi pas disa minutash, i mori darët dhe më tha ta hapja gojën. Pa asnjë farë problemi e hoqi dhëmballën. Më tha edhe pak të rrija ulur dhe mundesha të shkoj. Mjeku si doli në dhomën e mjekëve, motra më pyeti:

- A njihemi ne?! Unë i hapa sytë, e shikova dhe i thash nuk e dijë, ndoshta. Ajo tha ti nuk kujtohesh, por ajo kujtohet mirë, më tha ta ktheja kujtesën, disa vite pas, edhe atë për ahengjet në BORDELIN e kryeqendrës, siç i kam thënë dikur atje lart në mesin e bukurive të rralla të AVALLËS. Po ashtu tha se shumë mirë i kujtohet poezia e lamtumirës me titullin provokues dhe jo aq të qartë për atë kohë -FIKS VAKSINA- e bordelit, të cilën e kam shkruar atë ditë

në afërsi te Varri i Ushtarit të pa njohur. Pas këtyre fjalëve edhe njëherë më pyeti:

- A janë këto fjalët tuaja?! Atëherë u binda në fjalët, që i dëgjova pak më parë, dhe memoria u kthye pas më tepër se gjysmë dekade, kurse ajo vazhdoi:

-Për të më larguar prej asaj rruge BORDELIJANE, siç i thoshe ti atëherë dhe vetë vendose të largohesh, baba im kërkoi transferim në këtë vend ku jam tani. Kurse mua më vajti mendja te poezia e asaj kohe, ku mundet të ndodhet ajo poezi?!

Ditën e parë që u ktheva nga kryeqyteti, disa orë i shfletova librat e sjellë dikur në gjuhën e asaj, që më kujtoi poezinë, por dhe bordelet e viteve adoleshent. Më në fund ajo poezi e shkruar dikur në dialektin GEGË e të folmes së vendlindjes sime, ndodhej në librin “ NJERËZIT DHE TOKA” e nënshkruar nga kujdestari i klasës dhe të gjithë shokët dhe shoqet, që ma ka dhënë vet kujdestari, në emër të të gjithëve te stacioni i trenit, pak përpara se ai të nisej për në jug.

Nuk më kujtohet pas sa vitesh u takuam prapë, atje ku dikur kisha vizituar bordelet dhe kisha shijuar vaksinat. Por më të mplakur dhe jo të disponuar si vite më parë. Atë më tepër e brengoste shëndeti i babës, Gjeneral i APJ, por me VESHKA të KALBURA. Atje në kryeqendër më tha se pas disa ditësh gjenerali do të shkonte në kryeqytetin e shtetit më të madh dhe më të fortë në botën KOMUNISTE, për të operuar

dhe rigjeneruar veshkat e kalbura. Edhe unë i tregova se e kisha botuar poezinë e dikurshme.

Prej atij takimi shpejt në lajmet e mbrëmjes në televizion thanë “ Një ushtar i APJ ka bërë vetëvrasje”. Me siguri çdo prind, që kishte dëgjuar dhe parë lajmet, mendja i kishte shkuar te fëmija i vet ushtar.

Ditën e tretë po ashtu lajmëruan se ushtari i vetëvrarë është i rrethit të vendlindjes sime, dhe se është i kombit tim. Atë ditë në çdo shtëpi ndihej dhimbje, por më tepër e ndienin ato, që kishin fëmijë në APJ.

Varrimi u bë, dhimbja ishte e pa përshkruar. Çdo nënë dhe motër, qante dhe nëmte, atë dorë vrastare duke mos besuar në raportet e vrastarëve për vetëvrasje.

Nuk shkuan shumë ditë në trojet filluan të qarkullojnë disa kaseta. Në çdo kasetë qartë shihej masakra shtetërore ndaj ushtarëve të rinj të kombit tim. Ekspertët zbulonin se atyre u mungonin organet, shumicës u mungonin veshkat. Pas shikimit të atyre kasetave, mua mu kujtua gjenerali i APJ-ës, me veshkat e kalbura, atje në metropolin e shtetit KASAP të përbashkët, që KRYEKASAPI me kasapët e mbanin me dhunë.

Si e shkrova poezinë VESHKA PËR TRANSPLANTIM, por edhe disa të tjera, mora rrugën për në kryeqytetin e shtetit më të rinj në botë.

Dorën në zemër atje përherë më pritnin mirë. Edhe kësaj radhe redaktorët e revistave më pritën mirë. Edhe redaktori i gazetës për krijimtari për të rritur më priti mirë, por kur e pa titullin e poezisë, me fjalën transplantim i habitur e lexoi disa herë poezinë, dhe pak i nervozuar më tha:

- Këtë poezi unë nuk mundem ta lëshoj, bile as ta mbaj në zyrën time. E mora poezinë e futa në çantë, ashtu qetë u përshëndetëm dhe dola prej Pallatit. Duke e arsyetuar se kishte të drejtë, pse të humbte vendin e punës për një poezi. Por unë e arsyetoja edhe vetveten, atë që e bënte shteti te të rinjtë e kombit tim, ishte një krim i pa parë.

Të njëjtën poezi ia dhashë edhe redaktorit të gazetës së vetme shtetërore në republikën time. Por përgjigja ishte e njëjtë si e një dite më parë. Edhe aty u dëshpërova, por nuk u hidhërova. Po atë ditë me autobusin e parë urban udhëtova disa minuta deri sa arrita te redaksia e gazetës "TRIBUNA-SH. Për fat të mirë në vendin e punës e takova redaktorin. Si u përshëndetëm unë hapa çantën dhe ia dhashë disa poezi, por e para ishte ajo që ma refuzonin. Ai sa e lexoi titullin tha:

- Titull provokues. Unë nuk thash asnjë fjalë. Redaktori e lexoi me shumë vëmendje. E la në anën e djathtë. Dhe vazhduam bisedimin duke qarë hallet e jetës, por edhe për krijimtarinë në trojet mbarë shqiptare, por edhe për poezinë me përmbajtje të

krimeve shtetërore ndaj vëllezërve tonë, që kur i hapnim arkivolet i shikonim të qepur si arrën thesi të atyre me atë kësulën karakteristike, që shesin nëpër fshatrat tona, gështenja e molla.

Kënaqësia dhe dhembja u bashkuan më një nëntor, kur në faqen njëzetedy ishte poezia, aq e rrezikshme.

Gjenerali kalbej, por në memoaret dhe ditarin, që ia kishte lënë pjellës së vet shkruan: “ Me veshkat e ushtarit dhe ushtarëve të vetëvrarë, unë jetova plotë edhe një dekadë”. Kurse pjella e vet atje në afërsi të pallatit ALBANIJA, duke pirë raki të sertë do të më thotë: “ Përveç shpëtimit nga vdekja e sigurt të disa qindra personave të kombit tim, ne kemi përfituar edhe shumë para nga ato, që edhe sot e kësaj dite s’u dihet as nami e as nishani”. Plotësisht ka të drejtë ajo HAGOVIÇKA, por atë që e thotë për ty dhe kombin tënd, është dashur ta THOTË si BURRNESHË, për mua dhe KOMBIN tim, kurse JU ATJE hapni sytë...?!

SHKROLA E ZOTIT

Shumica kur do ta lexojnë këtë titull, do të thënë se është TEIST, e të tjerët do të thonë është ATEIST. Kurrë në jetë këmba e tij s'ka shkelur pragun e xhamisë. Secili ka të drejtën e vet, unë në xhami s' jam falur e lutur si ato, por i kam katër vepra me përmbajtje FETARE, dhe njohësit e mirë të asaj fushe kanë folur dhe shkruar mirë. Ose siç thotë populli secila dele, unë do të them DASH, do të varet për këmbës së vet, edhe unë llogari do ti jap ATIJ LART e jo këtyre poshtë, që urrejnë fjalën e shkrua, dhe sipas POROSISË së KRYQIT, të mos lihet gjurmë...?!

Si i botova disa vepra, dorën në zemër pak mu rrit mendja. Një ditë i thash vetes, pasi ka mundur ZHABA të provojë të mbathet si kali, pse unë të mos provoj si ato INTELEKTUALËT e MËDHENJ, të konkurroj nëpër konkurse, me një titull. Kur doli konkursi i parë përgatita dokumentacionin e nevojshëm dhe drejt e në postë. Për fat të mirë, kur u shpallë rezultati emri dhe mbiemri, së bashku me titullin e veprës në të gjithë gazetat, bile edhe te ato në gjuhën shtetërore. I gëzuar thash, sot do ta qeras vetveten, edhe atë me një raki të sertë burrash. A dini pse, hyra te ato të mëdhenjtë, por unë me vepra, jo vetëm intelektual, me diplomë parash dhe pak para në

xhep. I bëra krejt rendet dhe obligimet, ato duhej të më jepnin hakun-PARET. Dikush atje në kryeqendër më tha:

- Kush u njeh juve krijuesve! E veçanërisht ty si shqiptarë. Në se doni ta dini edhe ai vetë ishte i gjakut tim, ishte krijues bile grandioz, më tha se do të më ndihmonte se ai vet punonte në atë zyrë. Kur u ndamë tha hajde pas disa ditësh. Javën e dytë apo të tretë nuk më kujtohet, me trenin e mëngjesit drejt e në zyrë te ai. Prita pas dere si ai për kocin, ai më shihte, kur hapej e mbyllej dera, por komunisti atë e ka pasur në gjak dhe porosi e urdhër, që sa më shumë maltretim, aq më vlerë do të ketë vendi i punës, por edhe përfitime, mos habiteni ajo është edhe në demokraci bile edhe më tepër. Dikur edhe unë u futa në atë zyrë, që ishte hera e parë në jetën time. Ajo zonja më shikoi dhe nisi të më pyes për hallin, por zotëriu ia mori llafin prej goje siç thotë populli. Mu drejtua mua në gjuhën tash shtetërore, se unë nuk jam në kompjuter, por as në gazetë. Zonja rrudhi krahët, kurse unë e hapa çantën dhe dy gazetat në gjuhën time-zyrtare dhe një në gjuhën shtetërore ia tregova emrin, mbiemrin, titullin e veprës bile edhe të Shtëpisë Botuese. A e dini si u bë, si ai që i ka mbushur brekët, por edhe më shumë u hidhërua. Mua nuk më ngeli tjetër, vetëm të dilja prej zyre. Pas meje doli edhe ai, kur u përshëndetëm, më tha, mund të negociojmë! Unë dorën në zemër deri atëherë mendoja se mundet të

negociohet vetëm për politikë, apo emrin e ndonjë shteti, por ja diçka mësova dhe u binda në fjalën e popullit, sa jeton mëson.

Disa javë apo një muaj, nuk më kujtohet mirë shkova te Agjencia e Autorëve. Edhe ato nuk e morën me seriozitet, bile njëra qeshi, më shikoi dhe tha, dikush mundet edhe ti ketë hëngër ato të holla. Aty mu kujtuan disa shokë të mi me të njëjtin fat, që u kishin dhënë vetëm nga pesë ekzemplarë, honorarët dhe ekzemplarët tjerë i hëngri BUBA. Prej aty prapë te zyra e atij, rrugës mendoja edhe për negociata, por kush do të ishte lehtësuesi?! Dhe a do të pranonte lehtësues?! Pritja dhe përgjigjja ishte e njëjtë, emri im nuk ndodhet në kompjuter edhe pse është në shumë gazeta, goja iu mbyll, koka iu lëvar, mua s' më ngeli tjetër vetëm të lëshoja zyrën, edhe pse pak prita për negociata, bile e kisha caktuar edhe vendin, por ai edhe kur dola se hapi gojën. Populli thotë; dikush të shkel gjurmët, por fatin apo riskun assesi, ose SHKROLËN E ZOTIT SE FSHIN GOMA APO DORA E NJERIUT.

Duke zbritur shkallëve, në kokë më silleshin shumë mendime, që kisha dëgjuar, për shumë persona, por edhe për atë të zgjedhurin, bile mu kujtua edhe ai rasti kur bëmë zgjedhjen e Kryesisë të SHSHM-ës, kur unë dhe një krijues i mirëfilltë dhe serioz kishim vota të njëjta dhe duhej prapë të votohej ose njëri të tërhiqej. Në bisedë i zgjedhuri i tha ç' po

ja ... ti je më i mirë, dhe në votimin e dytë do të fitosh, prandaj mos u tërhiq, unë atëherë e ktheva kokën, më panë të dy, por i zgjedhuri, nuk mbeti me aq:- tha jemi të dy të mirë, kush fiton duhej të shtrihet dora. Unë thash, po, po, por çdo të bëhet me NËNËN?! I poshtri vetëm pak bëri së më të skuqur. Kur filloi mbledhja, për votimin e dytë, kolegu e mori fjalën dhe u tërhoq, nga votimi i dytë, unë edhe sot jam në Kryesi, jemi të përjetshëm si liderët partiak, kurse kolegut i jam mirënjohës. Kur arrita te shkalla e fundit e vërejta rrugicën e kuqe, me njëherë mu kujtua ajo rruga e gjatë prej një qyteti të shtetit të atij që ngordhi në Hagë. Kur arritëm përpara MONTANËS ai që na hapi dyert e Mercedesit të zinj korb, na shtroi edhe rrugicën e kuqe. Unë isha ulur pas shoferit, në anën tjetër ajo leshverdha furnizuesja e letrës, prej atje ku dikur SHKRONJAT e plumbit morën rrugën e gjatë, kurse në anën tjetër të shoferit ishte PIKTORI me DORËN e SAKATUAR.

Të nesërmen piktori më thirri në dhomën e leshverdhës, ajo i kishte hapur të dy sëndukët, plotë e përplot me bankënota prej atyre më me vlerë. Aty piktori më tregoi se për ato bankënota dikur ia kishin prerë katër gishta e dorës së majtë, që kurrë më të mos kapi brushë me dorë. Gishtin e madh deri në fund, atë tregues deri te thyerja e parë, të mesmin deri te thyerja e dytë, kurse atë afër të voglit vetëm gjysmën e thoit. Prej xhepi nxori një shumë parash, po ashtu edhe

leshverdha, kurse shoferi EKSPERT për PRERJE dhe përgjegjës i grupit më dha shumë më shumë se ata të dy.

Kur më kishin ngelur vetëm edhe dy hapa, në atë katrahurë, dikush me zë të lartë më thirri me emër e mbiemër, që unë nuk u besova as veshëve e as trurit. Kur ktheva kokën pas pashë ARTISTIN, që dikur për atë kisha shkruar poezinë "BALADA E URTISË". Më pyeti ç' e mirë më ka sjellë aty, por unë i thash; jo e mirë, por e keqe. Ua tregova rastin, artisti tha, ka mbaruar ajo punë, ky është personi kompetent. Kurse personi më tha që të kthehem prapë atje në zyrë te i zgjedhuri. Ai kur më pa në derë u habit, por unë ia përcolla fjalët e kompetentit. I zgjedhuri kur i dëgjoi fjalët sikur i ra DAMLLA. E gjeti emrin e mbiemrin në kompjuter, bile edhe shumë gjëra të tjera, që unë si kuptova. Javën e parë, arritën paratë, nuk e di a e dini sa?! Mos mërziteni ua tregoj, aq sa më kishte dhënë leshverdha, që ti harxhoja te Montana nën pisha -ELIKSIR- kundër Astmës, dhe atje te Guri i Arushës.

Kurse piktori më tha, se do ta bëjë "FIRMËN" e ndërmarrjes time më të mirë se "DY LUANAT", atje ku prehen eshtrat e ushtarëve të Hajredin Pashës...

DHURATË PËR KRYETARIN

Nesër bëhet plot një vit, kur i dhurova për ditëlindje VARKËN kryetarit të shtetit. Duke u falënderua, tha është hera e parë që i dhurohet një dhuratë e tillë, dhe po ashtu është hera e parë që një njeri prej qytetit të Hekuranës më të madhe në vend është kujtuar për ti dhënë dhuratë. Për plot një vit e bëra edhe këtë që shikoni, nesër do ta lëshojmë në ujin e trazuar të lumit, do të kalojmë në anën tjetër, për një piknik në vilën e babait.

Të nesërmen në afërsi të ankorimit u ndalëm me veturën dhe avokati më tha që të merrja njërën nga valixhet për ta çuar në varkë, gruaja e profesorit, në realitet ai ishte inxhinier, gruaja e tij ishte profesoreshë, por unë e thirrja edhe atë profesor. Ajo tha që të mos i prekja ato valixhe dhe të merrja atë që më jepte ajo. Avokati pak u nervozua, po ashtu edhe gruaja e tij. Profesoresha duke sharë, bile në atë moment shau edhe Zotin, atë e kishte një ves të keq jete. Tha se ato valixhe kanë ushqime që nuk i ha unë, prandaj edhe s' duhet prekur, kurse mua duke ma dhënë valixhen me ushqimin e përgatitur special për mua, tha në gjuhën time, te ato ndodhet mishi i keq i pjekur, dhe verë shtëpie, avokat e përgatit duke shtrydhur rrushin prej vreshtës së vet, në fillim bënë musht, pas një kohe bëhet verë, avokat e pinë si mishi

i atij që është pjekur, ti mos u mërzit unë përherë jam, dhe do të jem me ty, edhe unë kam pak besë, e dinë ku kam lind. Lumin e kaluam shpejt, në anën tjetër na priste babai i profesorit me shokun e vet. Aty ia uroi varkën djalit duke e sharë si shumë herë të tjera për dhuratën, që ia kishte dhënë kryetarit të shtetit më të madh në Ballkan, me arsye se KRYETARI dikur ia kishte konfiskua një pjesë të madhe të pasurisë dhe tash i kishin ngelur vetëm disa hektarë tokë për rreth vilës. Kurse ai xhaxhai, shoku i babait të profesorit edhe njëherë i përsëriti fjalët, që mi kishte thënë disa herë, për vrasjet e gjimnazistëve, dhe djalin e tij. Dhe prej atëherë, largohet prej ati qyteti, dhe deri në atë ditë kurrë këmba e tij nuk kishte shkelur atje, as e kishte vizituar varrin e të birit, duke e akuzuar kryetarin, për masakrën që kishin bërë komunistët për të njollosur okupatorin me mënyrën më të PISTË komuniste.

Vila ishte dy kat, mjaft e bukur me mobilije të stilit të vjetër, të punuara krejt prej druri. Ai hidhërimi i lehtë, që u bë andej lumit, mori fund duke cakërruar gotat e verës, kurse unë i cakërrova me lëngun e shtëpisë, që e kishte përgatitur vetë profesoresha e gjuhës frënge. Gruaja e avokatit, kur i cakërruam gotat më uroi për fjalët e bukura, që disa ditë më parë, në shtëpinë e tyre për mua i kishte thënë profesori i matematikës dhe gruaja e tij po ashtu profesoreshë e

gjuhës frënge. Profesori ndërtuesi i varkës tregoi se unë kam arritur shpejtësinë më të madhe në grup.

Në mbrëmje kur u ktheva në banesë baba dhe shokët e dhomës kishin shkuar në turnin e tretë. Unë disa orë mësova nën dritën e llambës së vajgurit, dhe freskinë që mora në vilën e bukur, me plot aromë lulesh u zhduk nga mushkëritë, duke u zëvendësuar me tym vdekjeprurës.

Të nesërmen, ditën e diel plotë tri orë isha në fushën e sportit së bashku me shokët, profesorin e fizkulturës dhe trajnerin e klubit. Këmbët s' më mbanin nga lodhja dhe uria. Duke shkuar për në banesë u ndala në afërsi të shtypshkronjës, te ëmbëltorja, që pronari krenohej më ndërtimin e xhamisë dhe minares me tri sherife, atje në vendlindje, në afërsi të lumit më të madh në Republikë. Ishte adhurues i flaktë i futbollit, në njërën anë të lokalit mbante fotografitë e disa klubeve, por me një madhësi të veçantë mbante portretin e lojtarit të atëhershëm-JUSUFI. Si e hëngra ëmbëlsirën e dytë bëhesha gati edhe për të tretën, u hap dera e lokalit, dikush hyri. U afrua afër meje dhe kërkoi që ti paguaja disa ëmbëlsira. Unë e refuzova, sepse shumë herë kisha dëgjuar në atë vend të shahej Zoti, që nuk ishte ai ves në vendin tim të lindjes, i helmuar me Vëllazërim-bashkimin Komunist, që s' donim të dëgjonim për lëmoshë e as për Zot. Edhe pronari nuk ia vendoi veshin, bile i tha, sa veta vinë si ju në ditë në

këtë lokal. Ajo prapë më tha bile u lut që ti paguaja disa ëmbëlsira, por unë vazhdova të hajë edhe ëmbëlsirën e tretë. Ajo u afrua më afër, ma kapi dorën e djathtë dhe tha:- paguaj atë që të kërkova do të tregoj për tërë jetën tënde dhe familjen. Më tepër u nervozova dhe fillova ta tërheq dorën, por disi nuk munda. I thash të ma lëshonte dorën isha i lodhur, ajo më tha nëse nuk mundem të paguaj aq sa kërkoi ti paguaja vetëm një. Unë edhe atë e refuzova. Më lëshoi dorën, duke më thënë:

- Paç vetveten më qafë. Do të tregoja edhe atë që dinë, por më shumë për atë që s' din dhe kurrë s' do të dish. Emrat e prindërve të tu fillojnë me germën, R dhe germën T. Është e vërtetë i thash. Ti tha shumë shpejt do të largohesh prej këtij vendi, as ti e DURON, por as ky VEND s' të duron. Unë në këto fjalë assesi nuk besova, sa kisha filluar shkollimin! Këtë që mendon të bëhesh, kurrë s' do të bëhesh, do të vuash mjaftë, por do të arrish shumë në fushë tjetër. Po ashtu do të jetosh gjatë, bile shumë gjatë, as prej njërës e as prej tjetrës s' do të thyesh qafën, por kur do të futet në trupin tënd ai i treti atëherë...?! Doli për dere, mu duk si ëndërr edhe pronari u habit, duke më thënë se kurrë atë person se ka parë në lokalin e vet, por edhe ato fjalë si ka dëgjuar kurrë. Edhe unë dola, për të shkuar atje në dhomën e FERRIT.

Nuk shkuan as plotë dy javë, sytë i hapa në spitalin e qytetit. Të nesërmen më dërguan atje në

kryeqendër, ku përpara një viti kishte arritur edhe VARKA e profesorit, dhuratë për kryetarin e shtetit, që me gojën plot llomotiste për DREJTËSI dhe të drejtat e punëtorëve, kurse baba dhe shumë punëtorë, vetëm disa kilometra larg tij, akoma s' kishin rrymë elektrike, por edhe muret e dhomës plotë lagështi...?!

U bënë më shumë se katër dekada, fjalët e dëgjuara, si në ëndërr te ëmbëltorja në afërsi të shtypshkronjës shumë herë në jetë më kanë shqetësuar dhe më shqetësojnë...?!

KANIBALËT E TOKËS

Nuk më kujtohet, as nuk e dijë, e kam dëgjuar apo e kam lexuar prej dikujt, por e di mirë se mua vetë më ka ndodhur, edhe atë atje lart te BAJRAKU. Ju atë vend dhe Bajrakun nuk e dini, sepse edhe unë vetë se kam ditur. Rastësisht dikur në dorë më ra libri i shkruar, përafërsisht njëqind vjet më parë nga njëfarë Cvijiqi dhe më vonë të një farë Smiljaniqi, edhe atë me urdhër të carit serb të atëhershëm, të vinë në vendin tim dhe të shkruajnë, të regjistrojnë popullatën, mëhallët por edhe toponimet. Të vinë ato se ne trurin e kemi pasur të mykur, më falni edhe sot ashtu e kemi, sepse ashtu i kemi politikucat, për fjalën e shkruar le që s' japin asnjë lek, por edhe tallen bile edhe të dënojnë.

Unë atje lart në afërsi të bajrakut, te ARA e SHJAUT, siç i thonë fshatarët, ajo në realitet është ARA e SHEGËVE. Si i ri ruaja bagëtinë, dikush do të tallet, për këtë që them se kam ruajtur bagëtinë, por unë edhe sot krenohem se kam qenë dhe jam njeri fshatar, apo rural dhe atëherë përgatitja provimin, mirë më kujtohet, Vizatimi teknik me Gjeometri diskriptive. Në afërsi pushonte Laroja, shoku im më i mirë, dhe në mes kishim shkopin, Laroja kur e lëkundi kokën që të largojë mizat, që se linin rehat, mua më

vajtën sytë te shkopi. Mbi të kishte hipur një mizë thnegle, apo milingonë, s' di si ta quaj sepse ishte pak më e madhe, ndoshta pse ishte rritur në mal, me kushte shumë më të mira se sa atje poshtë në fshat. Atëherë u çova e mora shkopin dhe prej pozitës horizontale e ktheva në pozitën vertikale. Milingona arriti përafërsisht deri te gjysma e shkopit dhe ra poshtë, por nuk largohej prej meje dhe shkopit. Prita pak që prapë të ngjitej, por ajo nuk deshi. E lash shkopin në pozitën horizontale dhe vazhdova punën. Dikur prapë më vajtën sytë te shkopi dhe milingona. Ajo kishte hipur mbi shkop dhe bënte disa lëvizje, apo rrotullime, me siguri hulumtonte terrenin, unë u çova dhe prapë e ngrita shkopin në pozitën vertikale. Krejt këtë ndodhi apo eksperiment ma prishën dy policët, që dolën prej dushkajave dhe u nisën drejt meje. Kur ato arritën edhe thnegla arriti deri te gjysma e shkopit. Ato filluan me pyetjet provokuese. Më vendonin në pozitë, që s' mundja të jap përgjigje. Njëri e pa librin me detyra të zgjedhura nga matematika, të Apsenit. Dhe mu vërsul si i çmendur për autorin duke menduar se fjala Apsen është e keqe. U mundova ta bind, por ishte kot. Dikur ai tjetri, pak më i shkolluar ia sqaroi, por ai i revoltuar nxori një bllok dhe filloi të më marri të dhënat, unë s' kisha rrugë tjetër vetëm ti tregoja atë që më pyeste, më në fund më tregoi dorën e prerë, i thash mos ke pirë gjak?! Ai tha, kam pirë dhe do të pimë, tërë familja ime ka qenë dhe është për këtë

shtet...! Laroja i shikonte herë ato e herë mua dhe lëvizte kokën, kurse unë shumë herë i çoja sytë te shkopi dhe miza. Në atë moment më vajti mendja te vizita e Muzeut të Cvijiqit; me plotë raketa, fluturake, libra, fletore dhe harta të ndryshme, atje diku në mes të HEKURANËS dhe fshatit, të XHAJIQIT, lojtarin e famshëm.

S'di cilën herë, por MILINGONA arriti deri në majë të shkopit, kur policët ndoshta raportonin për ditën operative. Unë me Laron u nisën në drejtim të bagëtisë, por ato baba pak përpara se të bënin zullum në arat e fshatarëve i kishte marrë në shtëpi, si shumë herë të tjera, se mua më merrte gjumi nëpër hije, kurse Laroja më bënte roje.

Pas disa ditësh në një kafene, takova shokun, tash gjykatës aktiv dhe më i vjetëri në qytet. Më përgëzoi për poezinë "TASH U RROTULLUA RROTA". Më tha se e kishte lexuar disa herë dhe kishte qarë, por të kem kujdes. Mua në atë moshë, kurrë nuk më kishte vajtur mendja se mundej të përgjigjet një autor pse ka shkruar një poezi të tillë, dorën në zemër më vajti mendje, atje te Bajraku, në librin e Cvijiqit që te Muzeu kishte vendin më prestigj, pastaj përmendet edhe te Smiljaniqi, KANIBALË të tokës sime, por edhe KANIBALË të popullit tim.

Pas disa ditësh, i vendosur i hipa trenit, i armatosur mirë me disa tituj, i kisha futur në çantë dhe assesi se lëshoja prej dore. Atje në kryeqendër zbrita

dhe drejt në Pallatin e shtypit, ku ndodheshin edhe redaksitë e gazetës dhe revistave tona. Si hyra te kati i parë, u ndala përpara ashensorit, ku prisnin edhe dy persona, atë njërin e njoha, se ishte i njohur bile unë kisha shkruar dhe botuar një poezi për atë me titull " KUKUDHI". Atë tjetrin nuk e njihja, por edhe ai ishte i atij SOJI, atë aty e pagëzova me emrin DRAKULLA. Duke pritur ashensorin, kukudhi i tha drakullës:

- Këtë që bëjë unë, shok është një PUNË e madhe, atë s' mundet ta bëjë askush...?! Kurse drakulla duke e parë me një cinizëm të pa parë i tha:

- Atë që bënë ti, s'është kurrgjë, ti dhe ato të tjerët duhet të punoni... Pas disa ditësh në një gazetë lexova, me urdhër të drakullës, kukudhi duhej krejtësisht të transformohej, prej HËNËS në KRYQ. Atje buzë liqenit dikush më tha, ato ditë kukudhin në afërsi të fshatit e kishin dënuar me zhveshje-lakuriq.

Unë u ndala aty ku duhej, kurse ato thyen qafën, në punë të vet. Fillova me rend, aty në afërsi të ashensorit, e hapa derën, por personi kompetent, sa më pa e uli kokën dhe assesi s' deshi të më shikojë. Unë e hapa çantën, që ti lejë punimet, por ai më tha, s'ka nevojë ka shumë punime prej meje. Me çantën e hapur shkova në dhomën tjetër, por edhe ai nuk më priti mirë, bile më tha:

- Një herë e hëngra, tash kam kujdes, lëri po të duash, por një kohë të gjatë do të pushoni. E mbylla

çantën dhe dola prej zyre. U ndala, u mendova pak, të hy edhe te dera e tretë, apo të pres ashensorin. Në fund vendosa të hap edhe derën e tretë. Për fat aty ishte personi që duhej. E përshëndeta edhe ai më përshëndeti, bile më tha që të ulem. U ula dhe e hapa çantën, ai duke qeshur më tha:

- Me çka do të na gëzosh këtë herë?! Unë ia dhashë disa punime, por ai duke qeshur, tha:

- Mos jenë si ato te "THUMBI" dhe ajo në redaksinë tonë...?!

Një faqe të revistës së atij muaji e kishte mbushur plot e përplot...

TOPI I QERSHISË

Për incidentin dhe atë që dëgjuat sot mos mërziteni. Ata janë të pa cipë, jetojnë me një civilizim të egër. Unë e thirra shoferin dhe u larguam nga reparti i të pa civilizuarve. Shumë herë në kthim pak kotesha, kurse sot fjalët e plakut; të pa kulturuar dhe civilizim të egër shumë herë më përsëriteshin në kokë.

Pak prej lodhjes dhe më shumë prej revoltës, sa mbërrina në qendër, pa mos hyrë në zyrën time, prej sekretares kërkova dhjetë ditë pushim. Ajo kishte kuptuar për incidentin, por nuk bëri zhurmë menjëherë i tha nëpunëses që të bënte gati vendimin. Me telefon bisedova me gruan, që edhe ajo të merrte disa ditë pushim. Ajo nuk pyeti pse, si e kanë zanat gratë.

Ishte dita e dytë që ishim vendosur në afërsi të urës prej ku buron Drini. Gruan dhe fëmijët i lash te byrektorja, kurse unë aty në afërsi shkova të blejë Flakën e vëllazërimit, në atë kohë ajo ishte gazetë e vetme në gjuhën shqipe. Duke ecur nëpër trotuar bëja edhe shfletimin e gazetës. Prej krejt titujve më interesant më erdhi titulli i shkruar nga i nderuari Prevalla. Edhe pse jo historian kishte zbuluar dhe shkruar një punim shumë interesant edhe nga aspekti artistik, por më shumë nga ai shkencor. E lexova disa herë. Në kokë filloi të më mundojë dhe të rrotullohet

diçka. Më në fund, mu kujtuan fjalët e ëmbla dhe qetësuese të plakut atje te reparti i mermerit. Po ashtu edhe të katër bashkëfshatarëve të tij, që sa e gjenin rastin ndaleshin dhe bisedonin me mua, me një sjellje shumë të kulturuar dhe me cipë.

Isha i detyruar, që një ditë përpara apo mbas mbarimit të muajit të vizitoja të gjitha repartet, po ashtu edhe atë të mermerit. Por tash më shkoja më i përgatitur dhe me një mision pak të çuditshëm, por edhe me një rezervë, sepse çdo reagim i atyre mundej të ishte i fatalët për mua. Më shumë kujdes dhe mjeshtri iu afrova plakut, së pari iu falënderova për fjalët e bukura. Edhe ai në mënyrë shumë njerëzore, më kapi për krahu dhe më tha:

- Jemi njerëz, bile edhe të një gjaku. Unë e shikova dhe në shpirt ndjeva një lehtësim. Si mora frymë thellë, i tregova për shkrimin e zoti Prevallës. Plaku duke qeshur tha:

- Unë nuk e njoh Prevallën, por ajo është e vërtetë, TOPIN e QERSHISË e kemi bërë NE, mendoj unë dhe ti. Dhe mua më vjen keq, bile shumë keq, që jemi larguar, bile shumë jemi larguar. Në atë moment na u afrua një bashkëfshatar, i thash që ta ndalnim bisedën, por plaku më tha se edhe ai është si ne, bile edhe më i flaktë. Në prezencën e bashkëfshatarit plaku tha:

- Ajo ndasi filloi atëherë kur prej fshatit u largua mësuesja dhe shkoi në qytetin ALFABETIT. Në atë moment plakut për faqesh iu rrokullisin dy sumbulla

lotësh. Më tregoi duart e plasaritura dhe të përgjakura. Prej këtyre plasave dhe këtij gjaku aspak s'kam dhimbje. Por prej këtyre që rrokullisen jam i dërrmuar. Dhe përmendi familjen QIRIAZI. Dhimbjen më të madhe e kemi përjetuar, atëherë kur dëgjuam se mësuesja në klasë, PËLLUMBAVE u thotë " PIS ARNAUTË", harron gjakun dhe tëmblin e nënës, që me siguri, kurrë s' do t'ia falë, dhe atje në amshim pranë nënës, nëse e pranon të rri në afërsi të saj, kurrë s'do të ketë qetësi. E lamë, bisedën ta vazhdonim ndonjëherë tjetër, në kushte dhe vend më të përshtatshëm.

Mua më vajti mendja te KOPILI i fshatit tim. Dikur pasi mbarova tetëvjeçaren, dikush atje në fshat më tha:

- Ai iku se nuk i takon këtij fshati, është kopil, as nëna e as baba s' janë të tij. Ato fjalë mi vërtetoi edhe nëna. Edhe pse u binda në atë realitet të hidhur, vendosa të bisedoja edhe me tezen, gruan që e rriti dhe ai e thirri nënë aty në fshatin tim, pak më pak se njëzet vjet. Edhe tezja me lot të përgjakur, shkurt më tregoi për historinë e shokut, që ishim rritur disa vite bashkë. Tezja më tregoi edhe çekun, që djali ia kishte çuar prej atje në kryeqendrën e shtetit artificial. Po ashtu më tregoi se pas disa javësh ai do të martohej dhe do të jetonte me nusen, atje ku në atë mbledhje KOSOVA do të marri pjesë si shtet i pavarur dhe i barabartë me të tjerët.

Si u ktheva prej fushës, baba mi dha paret e nevojshme për pushimin veror. Unë thash ti mbaj se akoma si kam kryer obligimet. Ai qeshi, i futi paret në xhep dhe më tha:

- Je pak i krisur, por e mban fjalën e dhënë. I thash, jemi apo s'jemi burra. Dhe i tregova, se pas pushimit, mendoj ti bëjë një vizitë, shokut të fëmijërisë edhe meqenëse ai ishte disa vite më i vjetër se unë. Baba aspak s'u mendua, por më tha se do të bëj mirë. Është rritur edhe në shtëpinë tonë. Prapë duke qeshur më tha: - do të duhen edhe pak më shumë pare. Edhe unë duke qeshur i thash se nuk do të më duhen më shumë se atëherë, kur pas pushimit në det i vizitova ato atje te liqeni në afërsi të Bullgarisë.

Pas njëzetepesë ditë pushimi në detin Adriatik, e nxora biletën për atje ku ndodhej shoku i fëmijërisë, apo siç u përfol disa ditë me radhë atje në fshat. Më priti shumë mirë, shumë i trimëruar, i tha nënës së gruas:

- Me vëllain e këtij jemi të një moshe, dhe jemi rritur si vëllezër, por këtë e kemi pasur përherë në shoqëri. Në atë moment gruaja e tij na thirri për të ngrënë, kurse pas saj edhe motra më e vogël, hyri me vajzën që u kishte lindur, përpara disa javësh. Atë natë deri vonë u çmallëm me lloj-lloj bisedash. Të nesërmen si hëngrëm mëngjesin shkuam atje te fabrika ku ishte punësuar disa muaj përpara. Në derë ishte emri, por mbiemër tjetër, me titull inxhinier i

lëkurave. Ia urova punën, por edhe titullin, që ne nuk dinim. Aty na gostitën me të gjithë të mirat e Zotit. Aty mu dha rasti, ta pyes për mbiemrin dhe pak të hynim në autobiografinë e tij. Vet më tha se ndoshta pak do të befasohem, për atë që do të më tregonte, por ajo është realitet. Baba tha ka marrë pjesë në luftën e Republikës së Krushevës. Ka qenë në Kryesi. Shumë vonë martohet, u lindin dy vajza dhe një djalë, pas tyre kam lindur edhe unë. Baba revoltohet prej shumë PADREJTËSIVE, dhe REBELOHET. Pas rebelimit bëhet likuidimi i tij. Unë kam qenë vetëm gjashtë javë, nëna ndoshta s' ka pasur rrugë tjetër, më bënë lurek dhe ditën e premte, më lenë përpara derës së xhamisë, me siguri kam qarë. Lajmërojnë organet, në atë moment dëgjon nëna, që është atje te ju, ajo s'ka pasur fëmijë, ajo më birëson dhe prej atje te qyteti i Republikës martohet në fshatin tuaj ku edhe unë së bashku me ju rritem. Në atë moment iu mbushën sytë me lot, e ndërpreva duke i thënë:

- E lejmë me kaq...?!

AL MATA HARI

Ishte ndalur te URA e dytë dhe shikonte në drejtim të rrjedhës së ujit. Në fillim se njoha, por kur u afrova edhe disa metra, u binda se ishte ai i viteve të krizës së tij adoleshente. Që të bindem edhe më mirë, i thash;-përmallu si dikur në të njëjtën vend! Njëri nga trupërojet e tij, më tha, të shikoj përpara dhe të hesht, se do të më gjejë ajo më e keqja. Atëherë ai ktheu kokën dhe u lëshua nga unë. Tërë trupërojet stepën. Biseduam si dikur, kishin kaluar më shumë se tridhjetë vjet. Më tha të takohemi, pas dy orësh atje ku një kafe kushton më shumë se pesë euro. E refuzova, ai qeshi më ra krahëve, duke më thënë; mos u mërzit, krejt do të jetë në rregull.

Trupërojet më njohën, dhe njëri nga ato më tha që të shkoja pas tij. Por lëvizjet me shumë kujdes. Tryeza ishte e mbushur, por karrigia në afërsi të tij ishte e zbrazur. Sa më pa në derë, vet u çua në këmbë por edhe të tjerët. Si pijet, po ashtu edhe ushqimi ishte prej atyre të më të shtrenjtëve. Ushqimi zgjati më shumë se dy orë. Unë kërkova të largohem, por edhe për një takim, ai më tha se do të ishte shumë vështirë për një takim tjetër, por atë ditë mundeshim të rrimë edhe disa ore, bile edhe pa prezencën e të tjerëve. Atë propozim e pranova. Dolëm në sallën e vogël. Ishin disa tavolina, te dy tavolina ishin ulur prej atyre të

eskortës, që nuk na pengonin. Në fillim biseduam për familjet, dhe hallet e jetës, më shumë unë se sa ai. Pastaj edhe për sëmundjen time, por edhe për të atij, pastaj edhe atë të jetës-krijimtarinë. Më tha se është i gëzuar që kam përparuar, por është dashur, që unë ti paraqitem, bile edhe ta vizitoj. I thash; as që më ka ra ndër mend. Pastaj i thash se ti ishe në pozitë, që me siguri s'ke ditur ku e ke kokën e jo shokët. Dhe mendja më vajti te ai nxënësi, kur e pyet profesoresha, vetëm por ti vënë një dysh, ku e ka kokën Ali pashë Tepelena?! Ai i përgjigjet:-profesoreshë unë s'di ku kam kokën time e jo të atij që thatë Ju?!

Pas gati një orë bisede e pyeta:

- Çfarë doni të thoni, disa herë e keni përsëritur, se ju e keni humbur luftën?! Pa mos u menduar tha:

- Ne e humbëm luftën me FITORE, kurse ju e fituat luftën me HUMBJE, edhe atë me humbje të thellë, për çdo ditë ajo humbje thellohet, dhe do të vijë deri në katastrofë. Fitorja e juaj është si FITORJA e PIRROS. Kurse mua më vajti mendja te tregimi i URTARIT xha Biti. Ndoshta dikush se ka dëgjuar, prandaj me ca fjalë do t'ua tregoj. Njëfarë kapadaiu, i gjakut tim, por edhe i juaji, që do ta lexoni, këtë shkrim, ka qenë shok i mirë i shefit të policisë serbe, sepse në atë kohë në këto troje kanë qenë serbët, bile ndoshta edhe sot janë. Vret komshiun e vet, dhe shkon te shefi të kërkojë ndihmë. Ai shumë i gëzuar i thotë: - të lumtë, mirë paske bërë ne jemi miq shko fli rehat,

bile siç thuhet në popull-pa brekë. Nuk shkon shumë kohë kapadaiu vret një të afërm, edhe për atë miku i thotë të lumtë, bile e shpërblen me një revole, të pa përdorur, kapadaiu krejt qejf. Kapadaiut i rritet mendja edhe më shumë. Shumë shpejt shkon dhe i thotë:

- Vrava edhe një tjetër. Miku edhe më i gëzuar i thotë; të lumtë unë pse ta dhashë revolen. Kapadaiu ndalet mendohet pak, shefi i thotë;-të kisha ta jepja edhe një revole, ose diçka më të madhe. Atëherë kapadaiu i thotë:

- Shef, nuk më pyetët cilin kam vrarë?! Shefi habitet, hëëë cilin vrave?! Kapadaiu pak si nëpër dhëmbë i thotë:

- Shef, unë sot vrava, njërin nga ato të tutë. Shefi çohet në këmbë, dhe i thotë:

- Çfarë ke bërë?!-Kapadaiu i thotë atë që i tha pak më parë. Shefi ia merr revolen, prej brezi e shtyn nga dera duke i thënë:

- Mos trego se e ke vra me këtë revole se të hanë dreqi. Tash shporru dhe ngordh atje në burgun e Nishit. Ku me mijëra shqiptarë, janë tharë dhe thahen në tavanin e burgut famëkeq. Besoni verës temperatura kalonte mbi plus pesëdhjetë gradë celsius, kurse dimrit po aq minus. Asnjërin Zoti mos e dërgoftë atje?!

Ne, tha pas luftës u mblodhëm siç thuhet në popull LIDERËT. U konsultuam mirë e mirë. Lidhëm BESË

të HEKURT. Bëmë një marrëveshje me ju si marrëveshja e UJKUT dhe QEVE. Njëherë t'ia hamë kokën njërit, pastaj është lehtë me tjerët. Marrëveshja përmban; ai që do të vijë me ne, kurrë mos të bisedojë dhe mos të ulet në tavolinë me rivalin, apo me opozitën, atë urrejtjen ndaj nesh ta kthejnë ndaj të vetëve. Atëherë unë i thash;- shumë mirë e keni kurdisur, por a do të keni sukses?! Tha shkurt, PO...?! Por, kjo po, na kushton shumë. Paguajmë ekspertë të jashtëm dhe të brendshëm, për SHPËLARJEN E TRURIT. Kurse mua më vajti mendja te filmi "NJË KOMB". Si bëhet tha kjo, pastaj e kemi lehtë, por duhej mjaftë kujdes, se një bashkim i tyre prishet HIPNOZA, apo SHPËLARJA. Mua më vajti prapë mendja te vrasja e një serbi nga kapadaiu jonë-shqiptar, dhe shefit të policisë sllave. A e dini sa kushton vrasje e një SLLAVI...?!

Do të tregoj tha, edhe një SEKRET. Pas humbjes, bile edhe para saj ne trajnuam edhe MATA HARA, ashtu si në kohën e LNÇ, që udhëtonin me tren, deri atje në kryeqendrën e shtetit artificial, që neve na bënë SHTET, bile të FORTË dhe PROBLEMATIK, por këto janë më të sofistikuara. Edhe atyre u janë shpërla trutë, por në një mënyrë tjetër, ajo shpëlarje nuk prishet kurrë. Në atë moment më vajti mendja te KIMISTI, kryetari i degës të qytetit më të ndotur në republikë, që herë-herë shet pjeshka e rrush, dhe bisedojmë me orë të tëra, si dikur, nxënës në

gjimnazin e qytetit, kur i ndihmoja nga lënda e matematikës. Por edhe te Pirroja kur hyri në qytet, i mungonin shokët më tepër se gjysma e gjysmës së gjysmës bile edhe të gjysmës.

Liderët dhe Mata Harat u bënë dhe na bënë KASHTË e KOQE. Për çdo ditë marrin poenë pozitiv, nga padroni, AI që i mban nën ombrellën e vet, deri atëherë kur për popullin e vet bëhen LIMONA.

Biseda me mikun s'kishte të sosur. Unë e pritsha si dikur ai të qante, si atëherë kur terë bukën e hante me tre qebapë, me shumë qepë dhe kërkonte vetëm të fut kokën në një dhomë dhe të shtrihej në çfarëdo krevati. Pak përpara se të mbaronim me bisedën, njëri nga rojet ia solli telefonin e kuq. Bisedoi bukur gjatë, pastaj edhe disa herë në mobil. Në fund duke shtrënguar duar si dikur e lamë të takohemi atje te Albena e bukur, në afërsi të katakombeve, te shkëmbinjtë e thepisur, te Manastiri i Allabaxhinovit, që dikur dyshonim në sinqeritetin dhe teizmin e sekretarit të PK të qytetit të vendlindjes së PAPËS të atëhershëm...?!

LEKA I MADH

Isha i lodhur dhe mjaft i mërzitur. Me mbesën përdore dhe nipin hopa, hyra në hapësirën e madhe të aeroportit. Përpara më doli diçka, që herën e fundit se kisha parë. E lëshova nipin dhe i kapa të dy përdore, u afrova më afër. Si mendova pak, u ktheva pas, pak më shumë se katër dekada. Përpara më doli parku dhe lumi më i madh i republikës, kur unë rrija dhe mendoja, për atë pak kohë, që më kishte ngelur për të përgatitur temën e maturës, ose do ta humbja një vit. Prej drejtimit të gjimnazit vinte, kujdestari i klasës, tash i ndjerë, ndjesë pastë. Pak i revoltuar, sepse ashtu ishte nga natyra, por edhe koha ishte për t'u trembur e veçanërisht për ne që kishim ardhur nga një qytet pak problematik, dhe ishim në klasën e tij, më bërtiti:

- Çfarë ke bërë, a dëshiron të na mbyllësh të tërëve?! Unë u habita, kurse ai ma dha letrën e postës dhe më tha;- sa më shpejt të paraqitesha në zyrën e drejtorit, ku më priste postieri. E nënshkrova letrën dhe e mora pakon. Drejtori më pyeti:

- Ç' lidhje keni me Ambasadën e Iranit. I thash shkurt:

- Është e drejtë e imja. Nëse dikush dyshon, ka organe, atje do të përgjigjem. Me pakon në dorë, shkova drejt e në klasë. E hapa përpara shokëve, shoqeve të klasës, kujdestarit të klasës dhe profesorit

të gjeografisë. Ishin disa libra në gjuhën perse, disa në gjuhën serbokroate, dhe ajo që ishte më me vlerë, për mua në gjuhën angleze. Kishte edhe disa harta të PRARUARA, një vizitë kartë të ambasadorit, në shtetin tonë të atëhershëm, dhe një letër nga vetë kryetari i Iranit shkëlqesia e tij SHAH REZA PAHLAVI, së bashku me një foto të Shahut, dhe familjes së tij, me përshëndetjet më të përzemërta.

Derisa unë përsiatja nipi dhe mbesa kishin shkuar me nënën dhe babën e vet. E pyeta Lekën, ç' e mirë e kishte sjellë aty?! Ai rrudhi krahët dhe heshti. Në atë moment erdhën dy persona, njëri me uniformë e tjetri, njeri shik. Me një sjellje shumë njerëzore më thanë:

- Dikush dëshiron të bisedojë me Ju, po të doni edhe ju të bisedoni, urdhëroni me ne. U thash në rregull, por nuk e dijë, sa do ti vlejë ajo bisedë, që do të zhvillojë me mua?! Ata rrudhën krahët, ai shik ma vendoi dorën në krahë, dhe më tha:

- Unë dhe ai nuk mendojmë ashtu siç mendon ti, dhe u nis në drejtim të restorantit. Kur arritëm te tavolina, mbesa u lëshua dhe më kapi për dore. Në atë moment edhe njeriu i cili dëshironte të bisedojë me mua u çua në këmbë dhe shtriu dorën, që unë habita. I dhashë dorë kurse ai e puthi mbesën. Unë në tavolinën e tyre e pashë gazetën 24 orë, të hapur në faqen OPINION, ku ndodhej fotoja.

Biseda zgjati mbi tridhjetë minuta. Ndoshta do të zgjaste edhe më shumë, por lajmëruan, udhëtarët që

do të udhëtonin në drejtim të Lubjanës, të kalonin doganën. U përshëndetëm si miq të vjetër, kurse unë me lotët që rrokulliseshin nëpër faqe, putha nipin dhe mbesën, dhe i shikova derisa u humbën nëpër kthinat e doganës.

Prapë vazhdova bisedën me LEKËN e MADH. I thash se për qime të flokut, shpëtova të mos bijë në provimin e maturës. Ai u habit dhe më pyeti, pse çfarë nuk dije?! I thash se njëra nga pyetjet shtesë ishte:

- Çfarë të keqeje i keni bërë DARJES?! Ai qeshi dhe shkurt tha;- është e vërtetë. Isha i ri siç jam edhe sot, por edhe i bukur, bile shumë më i bukur se sa jam këtu, këtu për çdo ditë shëmtohem, nuk është vendi im. Edhe AJO ishte e bukur, dhe e re, është e drejtë natyrore.

E pyeta për TRIMËRINË. Ai prapë shkurt më tha, atë e kemi në shpirt dhe gjak, trashëgim DENBABADEN. Pse më pyet, ti shumë mirë e din historinë e Skënderbeut, por edhe të tjerët, që vinë pas tij, bile edhe për ATË të kohës së sotme, edhe ti edhe unë edhe ata jemi të një gjaku. Mua më vjen keq, Ju gjakun shumë pak, apo fare se ruani, afroni dhe respektoni, mua më vjen po ashtu keq, bile shumë keq, edhe për mua, por më shumë për NËNËN E MADHE, e tërë bota e ruan dhe nderon, kurse Ju dëgjoni ato, që në emër të ATIJ lart dhe të atij...flasin keq e më keq dhe bëjnë treqind të zeza, e ju heshtni bëni amin ato veprojnë lirshëm, pse...?! Prapë ktheve

memorien pas te ai mevludi, kur profesori përkrahu çallmën pa të drejtë, dhe pastaj kërkoi falje cinike...?!

Në atë moment më vajti mëndja te nipi dhe mbesa, që më ishin lart mbi re. Fillova të lutem, që sa më mirë dhe më lehtë të përballojnë udhëtimin dhe të arrin shëndoshë e mirë në shtëpinë e tyre. Atje larg ku gjaku dhe takati i kombit tim, vlerësohet pak më shumë se sa në vendlindje e tyre, por jo aq sa duhej dhe të jenë të barabartë me vendasit. Por edhe te biseda e atij njeriut të madh, që përpara se të largohet më tha:

- Je kënaqur dhe kënaqesh, me fëmijët dhe tash me nipër e mbesa, që unë ua kam lakmi, pajtoheni me vajtje dhe sakrifica, por krijoni familje. Për faqesh iu rrokullisin ca lot. Unë kuptova se ai njeri aq i madh dhe i pasur nuk ishte i lumtur.

Ai mundohej me tërë botën ta lumturojë popullin e këtij vendi, por siç tha;-me njerëz të pa përgjegjshëm dhe NARCIZOIDË e ka dhe do ta ketë, apo do ta kenë bile e tërë bota shumë vështirë. Po ashtu më vajti mendja te habia e atij, për krenarinë dhe trimërinë e popullit tim, apo siç tha ai, duke e shqiptuar mirë fjalën KOMB. Ishte mjaftë i habitur, dhe i zhgënjyer prej krejt liderëve dhe deputetëve tanë. Gjatë tërë kampanjës zgjedhore llomotisin e premtojnë kur hynë në parlament, krejt atë e harrojnë, por që është më tragjike, harrojnë edhe atë më të shenjtën, fjalën KOMB, që gjatë bisedimeve në foltore, apo me të

huaj, përdorin terminë çuditëse, mendojnë se me ato fjalë do të na bindin se janë njerëz të mëdhenj, ndoshta mendojnë edhe për kozmopolitizëm.

Në fund më tha se ai e kishte studiuar mirë fjalën komb, dhe si me ironi tha:

- Kur hynë në koalicion, hynë si komb, aty mendojnë për MERCEDESË, kur dalin, dalin si FIQO. Mua më vajti mendja te ai i madhi ynë, dikur i DYTI, që nuk deshi të ndihmojë SHSHSHM, por edhe te të tjerët, që tash tërë ditën fërkojnë tespihe dhe... përshëndeten me; kërraba e sallama... kurse njeriu i madh i botës, ashtu serioz më tha:

- Kam menduar dhe kam qenë i bindur se te kombi i yt s' ka njerëz të pjekur, tash u binda jo vetëm që jeni të pjekur, por bile edhe të stërpjekur. Mos na dërgoni njerëz MIOPË dhe NARCIZOIDË...?!

S’ MBAHET TURPI

Dikur dikush erdhi në shtëpinë time si musafirë, dhe si bisedonim i pyeti vajzat e mija, që ishin të tria;- ç’ bënë babi juaj?! E madheje dhe ajo e vogla heshtën, kurse ajo e dyta tha:

- Babi, përditë hanë, pinë, lexon gazeta dha na bënë zhurmë me makinën e shkrimit. Pare i sjell postieri, kurse babi, kurrë s’ka shkuar në punë si mami. Qeshëm, por ajo ishte realitet. Unë edhe sot bëjë të njëjtën punë vetëm që tash nuk bëjë shumë zhurmë, kurse gazetat i kam blerë i blejë dhe do ti blejë, deri kur të kem frymën e fundit, edhe atë përpara se të blejë bukë, më ka ndodhur, dhe më ndodh për vajzat, nipër e mbesa të mos blejë akullore apo çokolatë, por nuk më ka ndodhur që të mos blejë gazetat e ditës. Vajzat nervozoheshin për mos plotësimin e dëshirave të tyre, kurse unë nervozohesha dhe nervozohem duke lexuar për sjelljen e pa kripur të disa, apo të shumicës të atyre funksionarëve AXHAMILLËKË. Si për shembull kur një prej atyre tha:

- Për shqiptarët është LEHTËSUESE edhe nëse i ndëshkon me njëqind shkopinj, apo u vendon mbi shpinë njëqind kilogram. Kurse për ato të tjerët është RËNDUESE, bile ofendues nëse mendon për RECIPROCITET. Kurse mua më vajti mendja te

thënia e dikurshme e URTAKU xha Biti, që të mos vendohen në krye PËRLAKËT dhe MËZËT.

Është realitet se neve kurrë s' na kanë nderuar dhe dashur këto të rrethit apo siç u themi komshi, edhe pse kemi qenë të kualifikuar si ato në atë rreth ku kemi punuar, e të mos flasim, nëse nuk kemi pasur kualifikim si ato dhe adekuat. Nuk duhet të hidhërohemi, s' janë tonët, as nga gjaku as nga feja. Mua sot dhe shumë herë përpara më është ngritur adrenalina prej axhamillëkut të funksionarëve të tyre e veçanërisht prej atyre të tonëve, që për shumë raste nuk kanë reaguar, kur ka qenë dhe është në pyetje kombi, por është mirë që janë zgjuar nga ai gjumi arushës dhe reagojnë për interesat e veta personale.

Ato axhamillëkët e tyre sillen si macja me miun; kur duhan të japin, kur duan të marrin, kur duan të...?! E unë duke lexuar gazetën dhe ashtu i nervozuar u zhyta në meditim, dhe s' di si u ktheva andej ka vitet pas trazirave në shtetin më të ri në botë, kur për ne ishte shumë rrezik, dhe mbanim kujdestari të çuditshme. Mua përherë më binte të mbaj nga ora, dy pas mesnate e deri në ora gjashtë të mëngjesit. Rrugës më ndalnin dy tri herë policët, por edhe në punë vinin, më provokonin, talleshin e silleshin, ashtu siç thash pak më lartë, por kjo nuk ndodhte vetëm me mua, por unë di për vetveten.

Atëherë më kishte COFUR ai POPI dhe pritej po ashtu të përfundojë edhe HOXHA. Këto këtu me ato

atje bënë një kontratë për shitblerje të manganit dhe kromit. Unë nuk mundem të them se kush cilin e rreni, apo siç thuhet në popull kush kujt ia futi, por e di se u mërzita, mua më doli pak punë, përkthimi. Kurse unë dorën në zemër isha mësuar me përtacinë, tamam siç i tha dikur, vajza ime e dytë dajës së vet.

Unë me shoferin e xhipit kishim shkuar të hanim mëngjesin në periferi të qytetit, që ajo ndodhte shpeshherë, e dija se njërit nga përgjegjësit e reparteve, që ishte si tepër kryelartë dhe mbahej si trim dhe i kishim pak të acaruara raportet i duhej xhipi dhe vozitësi, që edhe ai nuk ia kishte fort qejfin, po ashtu e dija se në atë kohë do të vinin edhe ato të hoxhës dhe unë duhej të bëja përkthimet dhe të udhëtoja me ato deri te reparti i manganit. Sa zbrita prej xhipit ai kapadaiu filloi të bërtet, kurse unë në atë moment e pash njërin nga vozitësit e hoxhës, se ai kishte qenë edhe më përpara, u përshëndeta dhe i thash të vinte në zyrë ku punoja. Ne sa u ulëm kapadaiu e hapi derën dhe filloi të bërtet. Unë e shikova dhe i thash;- hupu dhe mbylle derën. Ai shikoi vozitësin e hoxhës, më shikoi edhe mua dhe e mbylli derën, duke e lëkundur kokën. Unë dola porosita tri kafe, se në atë moment erdhi edhe ndihmësi i shoferit. Duke mbushur formularët në sy më ranë duart e shoferit, që ishin të katranosura, të çara, bile edhe të përgjakura. Dorën në zemër, mu dhimb. Duke shkruar sytë i drejtova në drejtim të

ndihmësit të tij, duart i kishte të pastra dhe të pa çara, të mos them si të mijat, se kurrë s' më kanë thënë:- pune mbarë, por mirë se rinë! Duke shkruar fillova tu bëjë edhe disa pyetje, pak provokuese. Shoferi i vërtetë sa herë që përgjigjej e shikonte ndihmësin, kurse ndihmësi përgjigjej pa asnjë droje. Bile pak u nervozua, pse unë u solla ashtu me përgjegjësin nga ndërmarrja e jonë. Dhe më tha, po të kishte qenë ai në vend të përgjegjësit do të më kishte ndëshkuar si përgjegjës. Unë i thash se edhe unë jam përgjegjës, për vendim tim të punës. Ai vetëm lëkundi kokën. Si i pimë kafetë unë u thash se edhe dokumentet janë gati mundet të shkojmë.

Kur dolëm në oborr, kapadaiu që ngutej për të shkuar në repart, jo që s' kishte shkuar, por bënte roje te dritarja e zyrës së drejtorit. Sa më pa tha; shok, sepse atëherë akoma s' dinim për fjalën zotëri, të thërret drejtori. U ktheva, kurse atyre u thash që të shkonin dhe të më pritnin te kamioni. Sa hyra në zyrë kapadaiu filloi të bërtet, se unë e kisha TURPËRUAR përpara mysafirëve nga shteti i hoxhës. Drejtori herë shikonte atë e herë mua. I thash mirë që kërkon ndihmën e drejtorit, por pse nuk kërkon edhe ndihmën e policisë, siç kanosesh shumë herë?! Drejtori u habit dhe më pyeti çfarë është problemi! I thash me siguri të ka treguar! Ai filloi të thotë diçka, por drejtori e ndërpreu. Kapadaiu arriti të thotë fjalën se e kam

turpëruar si pak më parë. Drejtori më shikoi dhe deshi të thotë diçka, por unë i thash:

- Mirë është që ti se mban turpin, por a duhej unë ta mbaj TURPIN nga ti, që u solle si kapadai i pa kulturuar dhe i pa cipë?! Kapadaiu si kapadai tha:

- Kush je ti, që se mban turpin?! A e din kush jam unë, duhej të kesh pak respekt për vendin e punës, që jam si përgjegjës?! I thash:

- Edhe unë jam përgjegjës dhe kemi një shkallë të kualifikimit, ti ke zgjedhur atë profesion, që të bësh punë tereni dhe ato kërkesat që i bënë kundër meje pas shpine tregoi haptas dhe dije se jam ai që s' mbajë TURP, bile edhe ta... atëherë tamam si qaraman mjekroshi partallmentit, siç i thotë Baca Salë, tha:

- Drejtor ky kanoset, siç tha ai se këto prapë na kanosen me krisje, kurse unë iu ktheva drejtorit:

- Me kësi budallenjsh dhe axhamillëku nuk mbahet ndërmarrja. Ky shikon si kalë, apo si ato që i përmenda në fillim, ndoshta një ditë do ti thyhej hundët. Ju thash vazhdoni, unë shkoj, më presin ato të hoxhës...?!

ZOTI ËSHTË KUDO

I kisha kaluar dy dekada dhe pak më tepër të jetës sime. Një shok dhe kushëriri më i madh prej ka dajallarët më thirrën që të vizitonim panairin që mbahej atje në kryeqendër. Dorën në zemër unë as që dija dhe as që kisha dëgjuar në atë kohë për panairet. Me trenin e parë të ditës arritëm në kryeqendër dhe për disa minuta edhe në sallat e mëdha të panairit. Ecëm afër një orë, por mua aspak nuk më interesonin ato materiale, apo aparate që ishin të interesuar shoku dhe kushëriri. Si pimë kafe te një shok i kushëririt, që kishte erdh nga Kroacia e largët dhe reklamonte mobilie mjaftë të shtrenjta, prapë filluam të vizitonim materialet që ishin të ekspozuara nëpër salla. Në një skaj pash të ekspozuar libra, u afrova kuptohet se ishin në gjuhë të shtetit tash më të shpartalluar, por jo edhe në gjuhën time. Duke shikuar përherë të parë në jetën më ra në sy KUR'ANI. Edhe ai ishte në gjuhën e kasapit të republikës më të madhe të shtetit. Por për mua dhe shumë të tjerë ajo gjuhë nuk ishte problematike, prandaj edhe e bleva, po ashtu bleva edhe Enciklopedinë e përgjithshme të Larousses, do libra të Apsenit dhe disa të tjerë.

Kur' anin e lexova shumë shpejt, sepse më interesonte. Pas një koha iu ktheva për së dyti, që më mori një kohë bukur të gjatë. Pas një kohe atje ku

dikur studioja në dorë më ra prapë Kur' ani por në gjuhën shqipe. Edhe atë e bleva, dhe fillova ta lexoj ashtu me vëmendje, që më mori një kohë afër dy vjeçare.

Nëpër revista dhe gazeta të kohës më kisha botuar një numër bukur të madh titujsh, kuptohej më së shumti poezi, por numri i krijimeve arrinte numrin me katër shifra. Krijimet ishin të larmishëm, një natë shumë shpejt e përpilova një poezi me karakter fetar, e pagëzova "Rrjedh dijenia". Të nesërmen e adresova për te "Hëna e Re". Edhe ajo shumë shpejt e pa dritën. Brenda disa muajsh shumë poezi të atij lëmi i adresova në disa revista të kohës, bile një edhe atje në kryeqendër ku jetonte satrapi i kohës. Edhe ajo e pa dritën në revistën "NURI". Dorën në zemër pak u kryelartësova, por ato siç do ti quaj tash ai atje në shtetin më të ri të botës me uniforma zyrtare, filluan të më injorojnë. E bëra përmbledhjen gati për botim dhe vajta atje në Qendrën Fetare të kërkoj ndihmë të ma financojnë, atje më kishte mbërri PETICIONI kundër meje. Me akuza reale, por edhe jo reale. Ato reale nuk i mohova, që si mohoj edhe sot. Dorën në zemër, kam pak qejf të pijë ndonjë gllënjkë, ashtu jemi ne krijuesit, por ajo s' është punë e atyre HAMAMËLLARËVE, për atë nëse ka nevojë do ti përgjigjem ATIJ LART. Shkurt u thash unë te ju kam sjellë punime me karakter fetar, nëse kanë vërejtje për punimet, atëherë unë do të kërkoj falje, dhe do të

përmirësohem. Ai i zyrës tha, punimet si luan topi, e ku ato palaço, të lumtë, por...???!!! Jo që s' më përkrahën për botimin e veprës, por mi ndaluan edhe botimet, JU LUMTË, u vërtetova se ato janë armiqtë e fjalës së shkruar në GJUHËN SHQIPE. Po ashtu më jam bindur, ndoshta edhe të tjerë, se ato janë më të rrezikshëm për gjuhën shqipe se sa SLLAVËT.

Siç thotë populli "Shkrolën e Zotit, askush s' mundet ta fshijë"?! Me plotë punime në çantë, dhe përmbledhjen " ZOTI ËSHTË KUDO ", u nisa në drejtim të fshatit ku më kishte filluar të punojë me kapacitet dhe plotë vullnet Universiteti. Aty botohej edhe revista për fëmijë me përmbajtje fetare, ku më ishin botuar disa poezi, dhe në numrat e fundit isha edhe anëtarë i redaksisë. Imami i xhamisë përgjegjës për arsimimin fetar të fëmijëve, si disa herë më parë më priti mirë. Duke pirë çajin dhe biseduar në lidhje me revistën dhe pastaj edhe për përmbledhjen time me poezi fetare, dikush trokiti në derë. Pas disa sekondash dera u hap. Ishte një burrë mesatar. Na përshëndeti dhe u ul në afërsi të imamit. Ne vazhduam me bisedën në lidhje me përmbledhjen time. Mysafiri dëgjonte me shumë vëmendje. Kur u bind se ne kishim edhe shumë për të biseduar, kërkoi leje prej imamit. Si e kapi me dorë bravën e derës, u kthe nga ne dhe tha:

- Këtu dëgjova fjalë të mira, zotëri hoxhë, a janë poezitë VËRTETË të mira ashtu siç dëgjova dha a

janë origjinale apo të përkthyera?! Hoxha përveç që pohoi me kokë, tha:

- Poezitë janë të shkëlqyera dhe janë origjinale, autori është zotëriu, por momentalisht na mungojnë mjetet, ndoshta na ndihmon Zoti dhe kjo përmbledhje (që e kishte në dorë) del në dritë, për fëmijët është një pasuri shumë e çmuar. Zotëriu si më tha mua, Zoti të më japi shëndet dhe jetë i tha hoxhës:

- Zotëri hoxhë, sa para duhet?! Hoxha tha atë shumë që ne e kishim biseduar pak më parë. Zotëriu duke hapur derën tha:

- Ato para i jap unë, dhe i sjell më vonë libri le të botohet. Unë atë moment nuk di si ta përshkruaj. Arrita ti them faleminderit dhe e pyeta për emrin, por ai tha:- emrin e din Zoti dhe doli për dere. Emrin e tij nuk ma tregoi as imami. Unë iu falënderova edhe njëherë hoxhës, por sot i falënderohem publikisht ATIJ PERSONI që me siguri nuk kishte mjete të tepërta, por kishte dashuri dhe respekt për fjalën e shkruar e veçanërisht për fjalën e BUKUR SHQIPE.

Pas gëzimit që e ceka pak më lartë do të vinë edhe shumë e shumë; hidhërime, nënçmime, nënvlerësime bile edhe ofendime, dhe pikërisht për librin me poezi të karakterit fetar.

Kisha shkuar në miqësi në shtetin tonë, që dikur pse e përmendnim dikush shkonte disa vite në burg, por duke iu falënderuar Zotit ndryshuan kohërat dhe politika. Kisha edhe dy orë kohë, prandaj dola të bëjë

një shëtitje aq të dashur nëpër qendër të kryeqytetit. Aty në afërsi të xhamisë te një barakë e vogël shkruante; LIBRARI. U afrova, si lexova disa tituj, që ndodheshin në vitrinë, hyra edhe brenda. Shitësi ishte një mjekrosh. Por tre të tjerë ishin ulur. Unë duke shikuar librat që të tërë ishin me përmbajtje fetare, e pash edhe librin tim "ZOTI ËSHTË KUDO", u gëzova si fëmija për çokolatë. E kërkova, mjekroshi ma dha por e vërejti foton, pastaj edhe mua. Më tha ju qenkeni autori, po iu përgjigja. Mjekroshi ashtu me inat tha:

- Poezitë janë mjaftë me mesazhe të mira, por TITULLI është shumë i keq. Atëherë njëri nga mjekroshët e mori e pa dhe e hodhi. I thash pse e mbani dhe e shitni?! Ju lutem më tregoni atëherë, çka nuk bënë?! Mjekroshi që ishte ulur tha:

- Zotëri, Zoti a ndodhet në NEVOJTORE?! U habita, prej asaj pyetjeje. I thash, unë nuk jam aq i mbërritur, që ta shikoj Zotin, apo të bisedoj me Zotin, por ama e di se edhe ato që kanë trurin HALE nuk kanë biseduar, apo parë Zotin. Unë mendoj se Zoti është edhe këtu ku jemi ne, edhe atje ku jetoj unë, por edhe në çdo skaj të botës. Mjekroshët filluan të nxehen, por edhe mua më afrohej koha e takimit, që do të jetë edhe më katastrofik se ky, besoj do ta lexoni...???!!!